

RAPORTI VJETOR 2025:

Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në përputhje me standardet e BE-së



RAPORTI VJETOR 2025:

Ndjekja e progresit të Shqipërisë në
lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve
në përputhje me standardet e BE-së



Sqarim

Ky raport, i titulluar “Raporti Vjetor 2025: Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në përputhje me standardet e BE-së”, u hartua nga një ekip i posaçëm kërkimor i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme.

Shkrimi dhe zhvillimi i përmbajtjes: Elira Canga, Orkidea Xhaferaj

Redaktimi shkencor: Flutura Kusari

Shpërndarja e pyetësorit dhe mbledhja e të dhënave: Isa Myzyraj, Osman Stafa

Analiza e të dhënave sasiore: Ilir Brasha

Me kontribut të veçantë: Blerjana Bino, Krisina Voko, Besar Likmeta

Përkthimi në shqip: Durim Tabaku

Ky raport u përgatit në kuadër të Projektit “Forcimi i Lirisë së Medias, Profesionalizmit dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri”, zbatuar nga BIRN Albania në partneritet me SCiDEV dhe Qendrën Fakte, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmëri pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe partnerëve të sipërpërmendur.

Tiranë, janar 2026

FALËNDERIME

Ky raport është rezultat i përpjekjeve dhe bashkëpunimit të shumë individëve dhe organizatave. U shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë ekipeve në SCiDEV, BIRN Albania dhe Faktaje për kontributin e tyre të paçmuar në hulumtimin dhe mbledhjen e të dhënave.

U jemi gjithashtu thellësisht mirënjohës ekspertëve të pavarur që ndanë me ne njohuritë dhe ekspertizën e tyre, si dhe gazetarëve dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që u angazhuan aktivisht në procesin e hulumtimit dhe mbështetjen punën tonë në mbledhjen e të dhënave.

U jemi thellësisht mirënjohës gazetarëve që gjetën kohë për të plotësuar pyetësonin, duke ndarë me ne përvojat dhe mendimet e tyre.

Së fundi, i shprehim mirënjohjen tonë Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri për mbështetjen e tij në realizimin e këtij raporti.

Ky raport pasqyron angazhimin dhe përkushtimin e përbashkët të të gjithë kontribuuesve për avancimin e mëtejshëm e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri. Ndonëse është bërë çdo përpjekje për të garantuar saktësinë dhe tërësinë e informacionit të paraqitur, në këtë raport jepen gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e ekipit hulumtues dhe e kontribuuesve. Raporti nuk pretendon të përfaqësojë një panoramë absolute apo përfundimtare të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, por është një analizë gjithëpërfshirëse e bazuar te të dhënat dhe opinionet e disponueshme në kohën e publikimit.

TABELA E PËRMBAJTJES

FALËNDERIME	5
SHKURTIME	9
LISTA E FIGURAVE	10
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	15
1. HYRJE	19
 1.1. Konteksti i lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri 2025	19
 1.2. Shqipëria drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian	25
 1.3. Qëllimi dhe struktura e raportit	27
2. METODOLOGJIA	28
 2.1. Qasja	28
 2.2. Hartimi dhe kampioni i sondazhit	28
 2.3. Avantazhet dhe kufizimet	33
3. MASAT E UDHËRRËFYESIT PËR SHTETIN E SË DREJTËS – NDJEKJA E PROGRESIT NË 2025	34
 3.1. Përqendrimi i pronësisë së mediave dhe transparenca	34
 3.2. Matja transparente e audiencës	37
 3.3. Dialogu i strukturuar për lirinë e medias	38

	3.4. Siguria e gazetarëve	41
	3.4.1. Perceptimet e përgjithshme për sigurinë dhe lirinë	42
	3.4.2. Përvoja me censurën mbi lirinë e raportimit	46
	3.4.3. Përvojat me sigurinë dhe kërcënimet	51
	3.4.4. Siguria e gazetarëve gra	60
	3.4.5. Denoncimi dhe reagimi	65
	3.4.6. Ecuria drejt dispozitave të Udhërrëfyesit lidhur me sigurinë e gazetarëve	71
	3.5. Kushtet e punës së gazetarëve	78
	4. UDHËRRËFYESI PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE	82
	4.1. Mbulimi i zgjedhjeve: aksesit, presioni dhe ndikimi në redaksi	83
	4.2. Ecuria në Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike	91
	5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	95
	5.1. Përfundime	95
	5.2. Rekomandime	96

SHKURTIME

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMI	Agjencia për Media dhe Informim
AMSD	Direktiva për Shërbimin e Mediave Audiovizive
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
DSA	Akti i Shërbimeve Digjitale
EMFA	Akti Evropian për Lirinë e Medias
ESAP	Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale
FIMI	Manipulimi i Informacionit dhe Ndërhyrja e Huaj
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
JIC	Komiteti i Përbashkët i Industrisë
KSHM	Këshilli Shqiptar i Medias
MPS	Sistemi i Matricës së Ndëshkimit
ODHIR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SAR	Sistemi i Analizës së Riskut
SCIDEV	Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim
SLAPP	Padi Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike
TV	Televizion

LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 1: Profili i të anketuarve sipas gjinisë</i>	29
<i>Figura 2: Profili i të anketuarve sipas grupmoshës</i>	30
<i>Figura 3: Profili i të anketuarve sipas përvojës në gazetari</i>	30
<i>Figura 4: Profili i të anketuarve sipas rolit në punë</i>	31
<i>Figura 5: Profili i të anketuarve sipas llojit të medias ku punojnë</i>	31
<i>Figura 6: Profili i të anketuarve sipas financimit të mediave ku punojnë</i>	32
<i>Figura 7: Profili i të anketuarve sipas nivelit arsimor më të lartë</i>	32
<i>Figura 8: Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion krahasuar me një vit më parë</i>	42
<i>Figura 9: "Si do t'i vlerësonit ndryshimet në aspektet e mëposhtme të gazetarisë në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?" Siguria e gazetarit, kushtet e punës, liria e shprehjes dhe aksesit në informacion, të dhënat e vitit 2025 krahasuar me ato të vitit 2024</i>	43
<i>Figura 10: Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion krahasuar me një vit më parë</i>	44
<i>Figura 11: Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion krahasuar me një vit më parë, sipas rolit të të anketuarit në gazetari</i>	45
<i>Figura 12: "Gjatë vitit të kaluar, a jeni ndjerë i/e lirë të raportoni për çdo temë pa frikë nga hakmarrja apo censura?"</i>	46

<i>Figura 13: Përqindja e të anketuarve që gjatë vitit të kaluar ose “vazhdimisht jam ndjerë e paaftë për të raportuar lirisht për shkak të frikës nga hakmarrja ose censura”, “shpesh përballesha me shqetësime në lidhje me hakmarrjen ose censurën”, ose “ndonjëherë jam ndjerë i/e kufizuar ose kisha frikë nga pasojat për tema të caktuara”</i>	47
<i>Figura 14: Tema ose fusha për të cilat të anketuarit ishin veçanërisht të ndjeshëm ose të kufizuar për të raportuar gjatë vitit të kaluar (Sipas gjinisë së të anketuarit)</i>	48
<i>Figura 15: Tema të ndjeshme ose të kufizuara të identifikuara nga të anketuarit gjatë vitit të kaluar, të kategorizuara sipas rolit, përvojës në media dhe llojit të medias (Më shumë se një përgjigje)</i>	49
<i>Figura 16: “Gjatë vitit të kaluar, a ju është dashur të braktisni/të mos publikoni një lajm ose kronikë për shkak të presioneve, vendimeve editoriale, censurës ose vetëcensurës?” (Sipas gjinisë)</i>	50
<i>Figura 17: Përqindja e të anketuarve që janë sulmuar fizikisht ose janë sulmuar gjatë punës si gazetarë në Shqipëri, rezultatet e vitit 2025 krahasuar me ato të vitit 2024</i>	51
<i>Figura 18: Përqindja e të anketuarve që janë sulmuar fizikisht ose janë bërë pre e sulmeve gjatë punës si gazetarë në Shqipëri sipas kategorive</i>	52
<i>Figura 19: Natyra e sulmeve (Vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)</i>	52
<i>Figura 20: “A ndikoi sulmi fizik në raportimin tuaj dhe, nëse po, si?” (Vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)</i>	53
<i>Figura 21: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose kanosje në lidhje me punën e tyre si gazetarë, rezultate e vitit 2025 krahasuar me ato të vitit 2024</i>	54
<i>Figura 22: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose kanosje në lidhje me punën e tyre si gazetarë, ndarje sipas kategorive</i>	55
<i>Figura 23: Lloji i kërcënimeve apo kanosjeve, vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve (Sipas gjinisë)</i>	56
<i>Figura 24: Shpeshtësia e kërcënimeve dhe kanosjeve të përjetuara sipas gjinisë (Vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)</i>	57

<i>Figura 25: Burimet kryesore të kërcënimeve apo kanosjes (Vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë)</i>	58
<i>Figura 26: Llojet e presionit të përjetuar nga gazetarët për të ndryshuar, vonuar ose hequr dorë nga raportimi (Vetëm ata që kanë qenë pre e presionit)</i>	59
<i>Figura 27: Në çfarë mase kërcënimet ose kanosjet ju kanë çuar në praktikimin e vetëcensurës në raportimin tuaj gjatë vitit të kaluar? (Vetëm ata që janë përballur me presion)</i>	59
<i>Figura 28: Përvoja e çdo kërcënimi ose kanosjeje specifike për gjininë në lidhje me punën si gazetarë (Vetëm gratë gazetarë të anketuara)</i>	60
<i>Figura 29: Lloji i kërcënimeve apo kanosjeve me bazë gjinore me të cilat janë përballur gratë (Vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë)</i>	60
<i>Figura 30: "Në çfarë mase kërcënimet ose kanosjet specifike gjinore kanë ndikuar në raportimin tuaj gjatë vitit të kaluar?" (Vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë)</i>	61
<i>Figura 31: "Gjatë vitit të kaluar, a keni ndjerë presion për të modifikuar, vonuar ose hequr dorë nga një histori specifikisht për shkak të gjinisë suaj?"</i>	61
<i>Figura 32: "A keni ndjerë se shqetësimet tuaja për sigurinë si grua gazetarë adresohen në mënyrë adekuate nga organizata juaj mediatike?" (Vetëm gratë sipas medias ku punojnë)</i>	62
<i>Figura 33: Masat e sigurisë për shkak të gjinisë (Vetëm gratë)</i>	63
<i>Figura 34: "Sa shpesh ndjeni që gjinia juaj ndikon në mënyrën se si burimet, kolegët ose të intervistuarit ju trajtojnë?" (Vetëm gratë, të dhënat e vitit 2025 krahasuar me ato të 2024)</i>	64
<i>Figura 35: "A besoni se të qenit grua gazetarë në Shqipëri paraqet sfida unike në krahasim me kolegët tuaj burra?" (Vetëm gratë)</i>	64
<i>Figura 36: "A jeni në dijeni të protokollit të posaçëm për sigurinë e gazetarëve të miratuar nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria?" (Sipas gjinisë)</i>	65

<i>Figura 37: "A jeni në dijeni për pikat e caktuara të kontaktit për sigurinë e gazetarëve në Prokurori dhe Policinë e Shtetit?" (Sipas gjinisë)</i>	66
<i>Figura 38: Përqindja e gazetarëve që raportuan kërcënimet ose kanosje te ndonjë autoritet ose institucion (Vetëm ata që u përballën me gjëra të tilla, të dhënat e vitit 2024 krahasuar me ato të 2025)</i>	66
<i>Figura 39: Arsyet pse gazetarët nuk i kanë raportuar kërcënimet apo kanosjet tek asnjë autoritet apo institucion (Vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë, por nuk e kanë raportuar tek asnjë autoritet, sipas gjinisë)</i>	67
<i>Figura 40: Autoritetet apo institucionet ku të anketuarit raportuan rastet e kërcënimeve apo kanosjeve (Vetëm ata që raportuan)</i>	68
<i>Figura 41: Reagimi nga autoritete të ndryshme siç raportohen nga gazetarët (Vetëm ata që raportuan rastet e tyre)</i>	68
<i>Figura 42: Ndikimi kryesor i kërcënimit apo kanosjes nga burimi (Vetëm ata që kanë qenë të kërcënuar apo kanosur)</i>	69
<i>Figura 43: Sfidat kryesore me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri kur bëhet fjalë për sigurinë dhe lirinë nga kërcënimet (Sipas gjinisë)</i>	70
<i>Figura 44: Masat apo veprimet kryesore që gazetarët besojnë se mund të ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri</i>	71
<i>Figura 45: Përmirësimi i kushteve të punës krahasuar me vitin e kaluar (Sipas rolit)</i>	79
<i>Figura 46: "A hasët vështirësi në aksesin në informacion gjatë raportimit të fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve të 11 majit 2025?"</i>	83
<i>Figura 47: "A hasët vështirësi në aksesin në informacion gjatë raportimit të fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve të 11 majit 2025?" (Sipas gjinisë, vetëm ata që mbuluan fushatën zgjedhore)</i>	83

<i>Figura 48: "Gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, a jeni përballur me ndonjë formë presioni ose kërcënimi në lidhje me punën tuaj si gazetar/e?" (Sipas gjinisë)</i>	84
<i>Figura 49: Burimi kryesor i kërcënimit ose kanosjes sipas burimit (Vetëm ata që kanë qenë të kërcënuar ose të kanosur gjatë fushatës zgjedhore)</i>	85
<i>Figura 50: "A keni qenë subjekt i sulmeve online (p.sh. komente ofenduese, kërcënime, diskreditime) gjatë mbulimit të zgjedhjeve?" (Sipas gjinisë)</i>	85
<i>Figura 51: "Nëse jeni përballur me presione, kërcënime apo sulme gjatë mbulimit të zgjedhjeve, a keni raportuar këto incidente tek institucionet kompetente?" (Sipas gjinisë)</i>	86
<i>Figura 52 "Sipas jush, si ndikoi periudha zgjedhore në lirinë tuaj për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe pa frikë nga censura?"</i>	86
<i>Figura 53: "Gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, a ju është ofruar nga partitë apo kandidatët material mediatik i parapërgatitur (video, audio apo tekst), duke shmangur pyetjet direkte apo intervistat?" (Sipas gjinisë)</i>	87
<i>Figura 54: "Nëse ju janë ofruar materiale të gatshme nga partitë apo kandidatët, a e keni ndjerë këtë praktikë si një mënyrë për të kufizuar punën tuaj si gazetar/e dhe pavarësinë editoriale?" (Sipas gjinisë)</i>	87
<i>Figura 55: "A jeni ndjerë të detyruar nga partitë apo kandidatët për të përdorur vetëm materialet e ofruara prej tyre, duke ju kufizuar mundësinë për intervista apo raportim të pavarur?"</i>	88
<i>Figura 56: "Si ndikoi praktika e materialeve të parapërgatitura në cilësinë dhe pavarësinë e raportimit tuaj gjatë zgjedhjeve?"</i>	89
<i>Figura 57: "A u kufizua aksesit juaj në evente zgjedhore, aktivitete të fushatës, apo deklarata publike të partive/ kandidatëve gjatë periudhës zgjedhore (11 maj 2025)?" (Sipas gjinisë)</i>	89
<i>Figura 58: "Në çfarë mënyre u realizua ky kufizim i aksesit tuaj si gazetar/e?"</i>	90

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2025, mjedisi mediatik në Shqipëri evoluoi me një trajektore të dyfishtë: kornizat institucionale u zgjeruan në përputhje me angazhimet në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), ndërkohë që dobësitë strukturore që prekin pavarësinë, pluralizmin dhe sigurinë e gazetarëve mbetën të pandryshuara. Në këtë raport bëhet një vlerësim i zhvillimeve në rregullimin e mediave, mbrojtjen e gazetarëve, reformën për shpifjen, mbulimin e fushatave zgjedhore dhe llogaridhënien institucionale, duke u mbështetur te përgjigjet nga institucionet, të dhënat e monitorimit dhe evidenca nga sondazhi me gazetarët.

Në përgjithësi, në vitin 2025 evidentohet progres procedural dhe ripërtëritje e vëmendjes ndaj reformës në media, edhe pse me ndikim disi të kufizuar. Janë miratuar ose forcuar masat mbrojtëse formale, kanë funksionuar mekanizmat e dialogut të strukturuar dhe kanë ecur përpara nismat ligjore. Gjithsesi, hendeku mes përafrimit formal dhe ndikimit në praktikë vazhdon të ndikojë në mjedisin mediatik në vend.

Transparenca dhe pluralizmi i tregut të mediave

Nëpërmjet bazës së të dhënave të transparencës së pronësisë të rregullatorit janë vënë në funksion mekanizmat për publikimin e pronësisë në sektorin e mediave audiovizive. Kjo bazë të dhënash është e aksesueshme për publikun. Paralelisht, është krijuar arkitektura institucionale për matjen e audiencës përmes krijimit të një Komiteti të Përbashkët të Industrisë (JIC) dhe hartimit të ndryshmeve ligjore, të cilat synojnë formalizimin e këtij kuadri. Nga ana tjetër, u ndërmorën hapa përgatitorë për të përafruar legjislacionin shqiptar me Aktin Evropian të Lirisë së Medias dhe Aktin e Shërbimeve Digjitale, ndonëse deri në fund të vitit nuk ishin miratuar ende zyrtarisht ndryshimet përkatëse ligjore. Po ashtu, mungojnë garancitë që trajtojnë përqendrimin dhe pluralizmin e medias. Si pasojë, ndonëse透明度 procedurale dhe strukturimi institucional kanë bërë hapa përpara, rreziqet strukturore që lidhen me përqendrimin e tregut dhe ndikimin e padrejtë të tij ende nuk po trajtohen në mënyrë të pamjaftueshme.

Dialogu i strukturuar dhe reforma ligjore

Gjatë gjithë vitit 2025 funksionoi një dialog i strukturuar me shumë aktorë të interesuara lidhur me reformën në media, dialog që përparoi nga konsultime tematike në shqyrtimin ligjor. Rekomandimet iu paraqitën Kuvendit dhe kontribuan në hartimin e amendamenteve ligjore që adresojnë mbrojtjen e gazetarëve dhe dispozitat e Kodit Penal. Megjithatë, ndjekja e mëtejshme mes rezultateve të dialogut dhe propozimeve dhe vendimeve përfundimtare legjislativë ishte e kufizuar, dhe niveli i reflektimit të rekomandimeve në reformat e miratuara do të varet nga zhvillimet e mëtejshme dhe zbatimi i tyre në vitin 2026.

Siguria e gazetarëve dhe zbatimi

Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e gazetarëve janë miratuar zyrtarisht. Policia e Shtetit miratoi udhëzime për sigurinë e gazetarëve, caktoi pika kontakti dhe inkuadroi module trajnimi në zhvillimin profesional të punonjësve të policisë. Prokuroria e Përgjithshme nxori një qarkore duke i dhënë përparësi rasteve që kanë të bëjnë me gazetarët dhe caktoi prokurorë të posaçëm për këto raste. Megjithatë, të dhënat nga sondazhi tregojnë për një ndërgjegjësim të ulët lidhur me këto mekanizma dhe besim të kufizuar te reagimi i institucioneve. Nga monitorimi i të dhënave del se janë regjistruar 42 raste në vitin 2025, ndërkohë që 40.6% e gazetarëve raportuan se kishin përjetuar kërcënime ose kanosje dhe 68% raportuan kufizime në aftësinë e tyre për të raportuar lirisht. Burimi kryesor i presionit mbeten aktorët politikë. Të dhënat sugjerojnë se, ndonëse ekzistojnë mbrojtjet procedurale, ndikimi i tyre parandalues dhe efektiviteti i perceptuar mbeten ende të kufizuara.

Reforma për shpifjen dhe përafrimi ligjor

Zhvillimet në vitin 2025 dhanë sinjale të ndryshme për sa i përket rregullimit të shpifjes. Në draftin e muajit korrik të Kodit të ri Penal ngriheshin shqetësime lidhur me zgjerimin e mundshëm të përgjegjësisë penale për veprat penale që lidhen me shprehjen. Në ndryshimet që u bënë më vonë në dhjetor, në Kodin Penal aktual u propozua shfuqizimi i dispozitave penale për fyerje dhe shpifje dhe transferimi i çështjeve të tilla te Kodi Civil, gjë që përbën një hap më pranë standardeve evropiane. Megjithatë, propozimet paralele për të dekriminalizuar shpifjen ekskluzivisht për gazetarët sollën rreziqe të mbrojtjes së diferencuar dhe pasigurisë ligjore. Puna përgatitore për transpozimin e

Direktivës (BE) 2024/1069 (anti-SLAPP) ka filluar, por deri në fund të vitit 2025 draft-amendamentet nuk ishin publikuar ende.

Periudha zgjedhore si test vështirësie

Zgjedhjet parlamentare të majit 2025 funksionuan si test praktik i angazhimit të institucioneve për lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve. Rreth 70% e gazetarëve që mbuluan fushatën raportuan vështirësi në marrjen e informacionit. Pothuajse gjysma raportuan se varësia të materialet e parapërgatitura kufizonte pavarësinë editoriale, ndërkohë që 23.9% raportuan se u përballën me presione apo kërcënime gjatë fushatës. Si burimi kryesor i këtij presioni u identifikuan kandidatët politikë dhe zyrtarët qeveritarë. Edhe pse nga pikëpamja sasiore monitorimi ishte funksional, nga ana cilësore pati kufizime, si kufizime aksesit, kontrolli i strukturuar i mesazheve dhe armiqësi digjitale, të cilat janë tregues se periudhat zgjedhore vazhdojnë të amplifikojnë presionet ekzistuese mbi gazetarinë e pavarur.

Sfidat strukturore ndërsektoriale

Në të gjitha fushat tematike shfaqet një model i përsëritur: respektimi në aspektin formal ka përparuar më shpejt se konsolidimi në aspektin funksional. Në sektorin e mediave vazhdojnë të ndikojnë probleme më të thella strukturore. Shqetësimet e vazhdueshme lidhur me pluralizmin e medias, marrëdhëniet e konsoliduara mes aktorëve politikë, interesave të biznesit dhe pronësisë së medias, rrjetet informale të trafikimit të influencës dhe rreziqet e integritetit krijojnë kushte në të cilat mund të ushtrohet presion i paligjshëm pa shkelur domosdoshmërisht mbrojtjet ligjore. Kushtet e pasigurta të punës dhe përfaqësimi i kufizuar kolektiv rrisin më tej cenueshmërinë në këtë sektor, ndërkohë që ngacmimi digjital dhe sulmet e koordinuara online sjellin forma të tjera rreziku. Këto dinamika, të kombinuara me ndryshimet në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik që ndikojnë në gazetarinë si profesion, vazhdojnë të ndikojnë në aftësinë e aktorëve të medias për t'u angazhuar në raportime të pavarura me interes për publikun. Kërcënimet me bazë gjinore janë ende të pranishme dhe një pjesë e konsiderueshme e grave gazetare raportojnë se kanë marrë masa paraprake pikërisht për shkak të gjinisë së tyre, duke nënvizuar natyrën e ndërlikuar të cenueshmërisë profesionale.

Implikimet për besueshmërinë e reformës

Teksa Shqipëria bën përpara brenda kuadrit të anëtarësimit në BE, besueshmëria e reformave që lidhen me median do të varet nga zbatimi i qëndrueshëm, përafrimi i plotë ligjor me standardet evropiane dhe zbatimi dhe qëndrueshmëria e reformave. Krijimi i procedurave për masat mbrojtëse është një hap i nevojshëm dhe i mirëpritur. Gjithsesi, për konsolidimin e progresit mbeten të një rëndësie kritike efektiviteti i vërtetueshëm i tyre, institucionalizimi dhe krijimi i besimit. Të dhënat e vitit 2025 sugjerojnë se, ndonëse janë miratuar kornizat e rëndësishme, nevojitet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të përkthyer në praktikë angazhimet në mbrojtje të qëndrueshme të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve.

1. HYRJE

1.1. Konteksti i lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri 2025

Në vitin 2025, mjedisi i mediave në Shqipëri evoluoi brenda një paradoksi: treguesit ndërkombëtarë pasqyruan një përmirësim relativ, ndonëse dobësitë strukturore mbetën ende problematike dhe, në disa aspekte, u bënë edhe më të dukshme.¹ Shqipëria u rendit e 80-ta nga 180 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit për vitin 2025, duke u përmirësuar me 19 pozicione dhe duke kaluar nga klasifikimi “i vështirë” në atë “problematik”.² Megjithatë, vlerësimet nga Rrjeti SafeJournalists³, nga organizata të shoqërisë civile në Shqipëri dhe organizata monitoruese të mediave nxjerrin në pah dobësitë strukturore që vazhdojnë të jenë të pranishme pavarësisht përmirësimit relativ të cituar më sipër. Nga monitorimi i vazhdueshëm⁴ gjatë gjithë vitit 2025 u dokumentuan tendenca të përsëritura të presionit politik, kanosjes, përqendrimit të pronësisë, financimit të errët dhe zbatimit të dobët nga institucionet, përfshirë këtu edhe gjatë periudhës zgjedhore.

Po ashtu, në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2025⁵ dhe në Kapitullin për Shtetin e Drejtës⁶ në Shqipëri vlerësohet se progresi në lirinë e shprehjes është i kufizuar, duke i përshkruar kushtet si kryesisht të pandryshuara dhe ende nën ndikimin e ndërthurjes së interesave të politikës me ato të biznesit, financimi i errët, përqendrimi i pronësisë, kanosjet dhe kushtet e pasigurta të punës. Liria e shprehjes dhe siguria e gazetarëve mbeten komponentë thelbësorë të grupit “Bazat” për anëtarësimin në BE, pasi ato lidhen drejtpërsëdrejti me shtetin e së drejtës, mbrojtjen e të lirive themelore dhe funksionimin e duhur të institucioneve demokratike.⁷

¹ Bino, B. (3 maj 2025). [Ngjitja Sizifiane e Lirisë së Medias në Shqipëri](#). SCiDEV.

² Reporterët pa Kufij. (2025). [Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit 2025: Shqipëria](#).

³ SafeJournalists. (2025). [Alarmet për Shqipërinë](#). Rrjeti SafeJournalists.

⁴ SCiDEV. (2025). [Njoftime për situatën e medias](#).

⁵ Komisioni Evropian. (4 nëntor 2025). [2025 Progres Raporti për Shqipërinë](#). Komisioni Evropian.

⁶ Komisioni Evropian. (8 korrik 2025). [Raporti për Shtetin e së Drejtës 2025 – Kapitulli: Shqipëri](#). Komisioni Evropian.

⁷ Këshilli i Bashkimit Evropian. (3 tetor 2024). [Negociatat e anëtarësimit: Grup kapitulli 1 – Bazat – Qëndrimi i Përbashkët i BE-së](#). Këshilli i Bashkimit Evropian.

Në Shqipëri liria e shprehjes dhe liria e medias vazhdojnë të jenë të garantuara me Kushtetutë. Ligjet sektoriale rregullojnë veprimtarinë e mediave audiovizive dhe gjatë vitit u hartuan mekanizma të strukturuar dialogu mes institucioneve dhe aktorëve të medias për të diskutuar lidhur me reformën ligjore dhe rregullatore.⁸ Ka filluar përafrimi me elementët kryesorë të Aktit Evropian të Lirisë së Medias (EMFA) dhe Aktit të Shërbimeve Digjitale (DSA), por ky proces është ende në fazën e hershme të transpozimit dhe përshtatjes institucionale. Në të njëjtën kohë, deri në fund të vitit shpifja ende konsiderohej vepër penale, nuk ishin miratuar mbrojtjet e posaçme kundër padive gjyqësore abuzive (paditë SLAPP) dhe kuadri ligjor nuk ofron mbrojtje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur për gazetarët e angazhuar në raportim në interes të publikut.

Megjithatë, në vitin 2025 nuk munguan mbrojtjet gjyqësore. Më 22 prill, Gjykata Kushtetuese anuloi vendimet e mëparshme që lejonin sekuestrimin e pajisjeve dhe materialeve të një gazetari gjatë një hetimi mbi krimin e organizuar.⁹ Gjykata arsyetoi se mbrojtja e burimit është jetike për lirinë e shprehjes dhe të drejtën e publikut për informim, duke përforcuar kështu kufizimet kushtetuese mbi masat hetimore ndërhyrëse. Ky vendim përfaqësonte një precedent të rëndësishëm mbrojtjeje. Ndikimi i tij në sistem, gjithsesi, do të varet nga zbatimi i vazhdueshëm nga gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe nga prokuroria.

Në vitin 2025, disa zhvillime sollën në fokus zbatimin praktik të garancive të shtetit ligjor, përfshirë këtu procesin e rregullt ligjor, proporcionalitetin e veprimeve shtetërore dhe mbrojtjen efektive të lirisë së shprehjes.

Më 6 mars 2025, gjatë periudhës parazgjedhore, Këshilli i Ministrave kufizoi aksesin në TikTok në të gjithë vendin për një periudhë njëvjeçare me arsyetimin e mbrojtjes së fëmijëve në internet.¹⁰ Shoqëria civile dhe organizatat monitoruese të medias e kundërshtuan publikisht masën, duke argumentuar se një kufizim i përgjithshëm i platformës ngre shqetësime lidhur me proporcionalitetin, domosdoshmërinë dhe procesin e rregullt ligjor në mbrojtjen e lirisë së

⁸ Këshilli i Evropës. (31 janar 2025). [Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri përmes dialogut të hapur 01.2025-12.2026](#). Këshilli i Evropës.

⁹ Deklaratë e përbashkët nga organizata të lirisë së medias. (prill 2025). [Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë Forcon Lirinë e Shprehjes në Çështjen Elton Qyno](#).

¹⁰ Sinoruka, F. (6 mars 2025). [Ministria e Arsimit konfirmon ndalimin për një vit të TikTok për të mbrojtur fëmijët](#). Balkan Insight.

shprehjes.¹¹ Masa u kundërshtua më pas në Gjykatën Kushtetuese,¹² ku procedurat vazhduan në fund të periudhës së raportimit. Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it¹³ mbi zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 tha se kjo përbënte një kufizim të gjerë dhe vuri në dukje se kufizonte mundësitë e fushatës së disa kandidatëve.

Zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 e rritën edhe më tej fokusin te shqetësimet për lirinë e shprehjes. Gjetjet nga monitorimi i mediave audiovizive¹⁴ dhe online¹⁵ të vitit 2025 nga BIRN Albania gjatë fushatës parlamentare ofrojnë evidenca sasiore të çekuilibrave strukturorë në vizibilitetin politik, politikat editoriale dhe shtrembërimet specifike të platformave, duke përforcuar shqetësimet e identifikuara në këtë raport në lidhje me pluralizmin e mediave, pavarësinë editoriale dhe drejtësinë zgjedhore. Përtej çekuilibrit strukturor në raportimin e mediave, organizatat e shoqërisë civile dhe mbikëqyrësit e lirisë së medias raportuan se partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës nuk arritën të respektonin plotësisht parimet e lirisë dhe transparencës së mediave.¹⁶ Monitorimi nxori në pah varësinë e madhe të materialet e prodhuara paraprakisht nga partitë politike, të pjesëmarrja e kufizuar në aktivitetet e fushatës dhe kufizime në aftësinë e gazetarëve për të bërë pyetje dhe për të raportuar në mënyrë të pavarur.¹⁷ Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it vlerësoi se fushata u zhvillua në një mjedis mediatik shumë të polarizuar dhe të kufizuar, ku dy partitë më të mëdha politike dominonin në raportimin televiziv të lajmeve ndërkohë që kandidatët e tjerë merrnin kohë më të kufizuar televizive.¹⁸ Në ditën e zgjedhjeve dhe në periudhën menjëherë pas zgjedhjeve,

¹¹ Rrjeti SafeJournalists, Media Freedom Rapid Response dhe OJQ-të. (11 mars 2025). [Ndalimi i TikTok në Shqipëri kërcënon lirinë e shprehjes përpara zgjedhjeve të përgjithshme](#). Deklaratë e përbashkët.

¹² Sadiku, D. (26 mars 2025). [Mbyllja e TikTok në Shqipëri, vendimi i qeverisë sfidohet në Gjykatën Kushtetuese](#). Shteg.

¹³ Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (23 tetor 2025). [Shqipëri, zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025: Raporti Përfundimtar](#). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

¹⁴ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). [Monitorimi i mediave audiovizive – Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025](#). BIRN Albania.

¹⁵ Voko, K., Babameto, S. & Keta, V. (2025). [Monitorimi i mediave online – Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 2025](#). BIRN Albania. Tiranë.

¹⁶ Deklaratë e organizatave të shoqërisë civile: [Deklaratë pas zgjedhjeve: Partitë politike dhe kandidatët dështuan në respektimin e plotë të lirisë dhe transparencës së mediave gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të 11 majit 2025](#).

¹⁷ Media Freedom Rapid Response dhe Rrjeti SafeJournalists. (12 maj 2025). [MFRR dhe SJN dënojnë intimidimin e hapur ndaj gazetarëve që raportuan për zgjedhjet parlamentare](#).

¹⁸ Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (23 tetor 2025). [Shqipëri, zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025: Raporti Përfundimtar](#). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

gazetarët u përballën me abuzim verbal, kërcënime, pengime dhe raste agresioni fizik në shumë vende, siç dokumentohet nga Rrjeti SafeJournalists.¹⁹ Prandaj, periudha zgjedhore evidentoi më së miri se si garancitë formale të lirisë së medias mund të minohen në praktikë kur aktorët politikë, organet ligjzbatuese dhe institucionet rregullatore dështojnë në punë e tyre për të mundësuar një mjedis të sigurt për raportim të pavarur.

Në korrik 2025, Ministria e Drejtësisë publikoi një draft të Kodit të ri Penal për konsultim publik,²⁰ duke rihapur debatin mbi fushëveprimin dhe proporcionalitetin e dispozitave të Kodit Penal që ndikojnë në lirinë e shprehjes. Drafti nxiti një analizë të thellë lidhur me ndikimin e tij të mundshëm në lirinë e shprehjes, në debatin publik dhe në gazetarinë profesionale.²¹ Edhe pse ministria më pas deklaroi se ndryshimet në dispozitat që lidhen me shpifjen ishin ende në shqyrtim dhe se po vazhdonin konsultimet, përafrimi përfundimtar me standardet evropiane mbeti pezull deri në fund të vitit.²² Prandaj, reforma penale doli si fushë kyçe për vlerësimin e përafrimit praktik me parimet evropiane, veçanërisht për sa i përket domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe parandalimit të efekteve frenuese në aktivitetin legjitim të gazetarëve.

Në gusht 2025, pengimi i punës së gazetarëve të Focus Media Group u bë një nga incidentet më të rënda të shtetit të së drejtës që ndikuan në lirinë e medias gjatë vitit të kaluar. Gjatë një procesi dëbimi nga ndërtesat shtetërore, autoritetet bllokuan aksesin në godinat ku kishin zyrat disa media, si News24, Balkanweb, Panorama dhe Gazeta Shqiptare; në këto ndërtesa u ndërpre energjia elektrike, gazetarëve iu ndalua të hynin në redaksitë e tyre dhe u ndërpre në aktivitetet normale editoriale dhe transmetimi nga këto media.²³ Incidenti u dokumentua përmes alarmeve të monitorimit dhe më pas u trajtua në deklaratat të koordinuara nga organizatat e lirisë së shtypit, të

¹⁹ Rrjeti SafeJournalists. (11 maj 2025). [Dënojmë Sulmet dhe Frikësimet ndaj Gazetarëve gjatë Ditës së Zgjedhjeve në Shqipëri](#). Rrjeti SafeJournalists. (11 maj 2025, May 11). [Rrjeti SafeJournalists dënon ashpër abuzimin verbal, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve nga zyrtarë dhe mbështetës të Partisë Demokratike](#).

²⁰ Ministria e Drejtësisë. (25 korrik 2025). [Drafti i Kodit të ri Penal](#). Ministria e Drejtësisë.

²¹ Sinoruka, F. (2025, August 12). [Alarm në Shqipëri për ndryshimet e propozuara në Kodin Penal; Qeveria mohon përfshirjen](#). Reporter Albania

²² Për më shumë hollësi klikon [këtu](#).

²³ Rrjeti SafeJournalists. (9 gusht 2025). [Sulme ndaj medias dhe organizatave mediatike, News24, BalkanWeb, Panorama dhe Gazeta Shqiptare, 09.08.2025, Tiranë](#), Tiranë.

cilat ngritën shqetësime në lidhje me procesin e rregullt ligjor, proporcionalitetin e masave zbatuese dhe mbrojtjen e të drejtës së gazetarëve për të punuar dhe për të aksesuar materialet e punës së tyre.²⁴ Më vonë një gjykatë e shkallës së parë i konsideroi këto masat kufizuese si joproporcionale dhe urdhëroi kthimin e pajisjeve dhe dokumenteve. Megjithatë, më pas u ngritën shqetësime lidhur me zbatimin e vendimit, pasi urdhri për kthimin e materialeve nuk u zbatua siç duhet.²⁵ Ky episod nxori në pah dobësitë strukturore në zbatimin praktik të garancive për lirinë e medias dhe demonstroi se si veprimet ekzekutive, veçanërisht kur zbatohen pa garanci të qarta procedurale, mund të gjenerojnë efekte të frikshme.

Gjatë gjithë vitit 2025 u rritën shqetësimet lidhur me strukturën e qeverisjes së transmetuesit publik. Në fillim të vitit 2025, u raportuan parregullsi procedurale në procesin e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, ndjekur nga shkarkimi i Këshillit Drejtues nga Kuvendi dhe emërimi më pas i një këshilli të ri.²⁶ Megjithatë, pati shqetësime lidhur me ndikimin politik të Këshillit të ri Drejtues të RTSH-së. Në prill 2025, Këshilli Drejtues i sapokrijuar zgjodhi një Drejtor të Përgjithshëm të ri.²⁷ Tranzicioni i leadershipit u shoqërua me deklarata për detyrimet financiare të akumuluar, mosmarrëveshjet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe sfidat e menaxhimit brenda RTSH-së.²⁸ Këto problematika nënvizuan dobësitë strukturore në menaxhimin dhe pavarësinë e transmetuesit publik, duke ngritur pyetje nëse emërimet ishin të bazuara në meritë, për autonominë institucionale dhe mbrojtjen kundër ndërhyrjeve politike dhe administrative në përputhje me standardet evropiane për median e shërbimit publik.

Struktura e tregut mbeti një sfidë e pazgjidhur. Monitori i Pluralizmit të Mediave 2025 vazhdoi ta klasifikonte Shqipërinë mes vendeve evropiane me rrezik të lartë për sa i përket përqendrimit të pronësisë së mediave dhe transparencës së reklamave shtetërore.²⁹ Pronësia e medias mbetet e

²⁴ Deklaratë e përbashkët nga organizatat për lirinë e medias. (gusht 2025). [Shqipëri: Nevojiten urgjentisht përgjigje mbi pengimin e bërë ndaj Focus Media Group dhe të drejtën e gazetarëve për të ushtruar detyrën.](#)

²⁵ Deklaratë e përbashkët nga organizatat për lirinë e medias. (gusht 2025). [Grupet për Lirinë e Shtypit Kërkojnë Veprime të Menjëhershme për Zbatimin e Vendimit Gjykatës dhe Mbrojtjen e Gazetarëve në Shqipëri.](#)

²⁶ Rrjeti SafeJournalists. (janar 2025). [SafeJournalists: Shqetësime për procesin e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH në Shqipëri.](#)

²⁷ Gjoka, B. (24 mars 2025). [BE shpreh shqetësimin për ndikimin politik në bordin e ri drejtues të RTSH.](#) Reporter.

²⁸ Sinoruka, F. (1 shtator 2025). [Transmetuesi Publik i Shqipërisë po përballët me borxhe “katastrofike”, thotë Drejtori.](#) Balkan Insight.

²⁹ Voko, K. dhe Likmeta, B. (2025). [Raporti për Pluralizmin e Mediave: Profili i vendit: Shqipëria.](#) Qendra për Pluralizmin e Medias dhe

përqendruar tek aktorë me interesa më të mëdha ekonomike që varen nga koncesionet shtetërore dhe sektorët e rregulluar, duke përforcuar stimujt për përafrim të politikave editoriale dhe jo raportimit të paanshëm.³⁰ Mungesa e rregullave të qarta dhe transparente që rregullojnë subvencionet indirekte dhe reklamat publike deformon edhe më shumë konkurrencën dhe thellon varësinë financiare. Janë ndërmarrë hapat e parë për rritjen e transparencës së tregut, përfshirë këtu funksionimin e regjistrimit të pronësisë së medias pranë AMA-s dhe krijimin e një Komiteti të Përbashkët të Industrisë për matjen e audiencës.³¹ Megjithatë, si mekanizmi i publikimit të pronësisë ashtu edhe ai për matjen e audiencës mbeten ende në një fazë të hershme të zbatimit efikas të tyre.

Përtej faktorëve institucionalë dhe të tregut, mjedisi mundësues për punën e gazetarëve mbeti i brishtë. Gjatë vitit 2025 Rrjeti SafeJournalists regjistroi 42 raste të shkeljes së sigurisë së gazetarëve dhe lirisë së shprehjes, kryesisht në formën e sulmeve verbale, ngacmimeve online dhe fushatave të shpifjes.³² Nga monitorimi i tyre u dokumentuan kërcënime të vazhdueshme dhe sulme digjitale, veçanërisht me objekt sulmi gratë gazetare,³³ së bashku me kushtet e pasigurta të punës. Gazetarët vazhdojnë të punojnë në kushte të paqëndrueshme pune, të karakterizuara nga informaliteti, paga të parregullta dhe mekanizma të dobët për negociatat kolektive.³⁴ Këto kushte ndikojnë shumë në autonominë profesionale duke e tkurrur atë dhe rrisin ndjeshmërinë ndaj presioneve politike, ekonomike dhe ligjore.

Transformimi digjital i ekosistemit mediatik ka rritur tej mase si mundësitë ashtu edhe rreziqet. Përhapja e portaleve të panjohura online,³⁵ fushatat e koordinuara të shpifjes³⁶ dhe dezinformimi i gjeneruar nga inteligjenca artificiale, veçanërisht i dukshëm gjatë periudhës zgjedhore, intensifikuan kërcënimet ndaj integritetit të informacionit. Në korrik të vitit 2025, Kuvendi

Lirinë e Medias, Instituti i Universitetit Evropian.

³⁰ Karaj, V. (12 gusht 2025). [Si 'përfitimet strategjike' nga qeveria po rrezikojnë lirinë e medias në Shqipëri](#). Reporter.

³¹ Shih AMA-n: [Baza e të dhënave struktura pronësore e OSHMA](#).

³² Shih [SafeJournalists, baza e të dhënave e incidenteve](#).

³³ Bino, B. (2025). [Siguria e Gazetareve Gra: Raporti për Shqipërinë 2024](#). Rrjeti SafeJournalists.

³⁴ Karaj, V. & Mitre, O. (2025). [Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2024-2025](#). Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

³⁵ Bino, B. (2025). [SHQIPËRIA: Treguesit për Nivelin e Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2024](#). Rrjeti SafeJournalists.

³⁶ Likmeta, B. (23 maj 2025). [Kandidatët për deputetë shkelën heshtjen zgjedhore me reklama politike në Facebook](#). Reporter Albania.

miratoi Strategjinë e parë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit.³⁷ Edhe pse kjo strategji e përafuron Shqipërinë me kuadrin e gjerë evropian për luftën ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit, zbatimi i kësaj strategjie mbetet i një rëndësie të madhe. Pa masa të qarta mbrojtëse, pa transparencë dhe proporcionalitet, strategjia e dezinformimit rrezikon të perceptohet si një instrument që rregullon lirinë e shprehjes dhe jo si një mekanizëm që frenon dezinformimin.

Të marra së bashku, zhvillimet në vitin 2025 përshkruajnë një mjedis mediatik të karakterizuar jo nga represioni i hapur sistematik, por nga ekspozimi strukturor ndaj ndikimit politik, nga varësia ekonomike, kanosja digjitale dhe zbatimi i dobët i masave mbrojtëse. Kuadri ligjor vazhdon të evoluojë dhe ekzistojnë platforma dialogu. Gjithsesi, viti 2025 tregoi se liria e medias në Shqipëri vihet në provë nga ushtrimi në praktikë i detyrës: kapaciteti zbatues, proporcionaliteti i masave shtetërore, pavarësia e strukturave qeverisëse, transparenca e tregut dhe mjetet juridike efektive. Edhe pse anëtarësimi në BE përparon sipas grup-kapitullit të Bazave, besueshmëria e reformës do të varet gjithnjë e më shumë nga zbatimi i vërtetueshëm në praktikë dhe jo nga respektimi i procedurave.

1.2. Shqipëria drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Në vitin 2025, Shqipëria arriti një moment historik procedural në procesin e anëtarësimit në BE me hapjen e të gjithë grup-kapitujve të mbetur të negociatave.³⁸ Ky zhvillim shënoi avancimin formal të negociatave në të gjithë kornizën e acquis dhe ishte tregues i angazhimit të vazhdueshëm politik me axhendën e zgjerimit. Hapja e të gjithë grup-kapitujve sinjalizoi vrullin institucional dhe përpjekjet për përafrim në shumë fusha të politikave, duke e pozicionuar vendin në një fazë të përshpejtuar të negociatave.

Në Paketën e Zgjerimit të vitit 2025, Komisioni Evropian e vlerësoi objektivin e Shqipërisë për të përfunduar negociatat deri në fund të vitit 2027 si ambicioz, por “në rrugën e duhur”, me kusht që

³⁷ Kuvendi i Shqipërisë. (2025). [Strategjia Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit](#).

³⁸ Komisioni Evropian. (2025). [Shqipëria: Statusi i vendit kandidat](#).

të ruhej vrulli i reformave.³⁹ Megjithatë, progresi në kuadër të grup-kapitullit të Bazave, që mbulon shtetin e së drejtës, institucionet demokratike dhe të drejtat themelore, mbetet i një rëndësie parësore për besueshmërinë dhe vazhdimin e procesit të anëtarësimit. Komisioni vuri në dukje progres të kufizuar në fushat që lidhen me lirinë e shprehjes dhe theksoi se mbeteshin ende të pazgjidhura problemet strukturore që ndikojnë në pavarësinë e medias, transparencën dhe mbrojtjen e gazetarëve.⁴⁰

Këshilli i Bashkimit Evropian ritheksoi se mbrojtja e të drejtave themelore përbën një gur themeli për kuadrin e anëtarësimit.⁴¹ Garantimi i lirisë së shprehjes, mbrojtja e gazetarëve nga kërcënimet dhe kanosjet, si dhe nxitja e një mjedisi të favorshëm për gazetarinë e pavarur u theksuan si të një rëndësie jetike për funksionimin e duhur të institucioneve demokratike.

Në analizën e pavarur të vitit 2025 trajektorja e Shqipërisë drejt BE-së përshkruhej si e karakterizuar si nga momenti plot vrull ashtu edhe nga ngërçet.⁴² Edhe pse hapja e shpejtë e kapitujve të negociatave u njoh gjerësisht si një arritje e rëndësishme, vëzhguesit paralajmëruan se përshpejtimi duhet të shoqërohet me përmirësime të matshme në qeverisjen demokratike, pavarësinë institucionale dhe mekanizmat e llogaridhënies.⁴³ Rreziku që u identifikua është mundësia që përparimi i shpejtë i negociatave të anashkalojë reformat më të thella strukturore të nevojshme për konsolidimin e demokracisë në vend. Në këtë kontekst, zhvillimet që ndikojnë në shtetin e së drejtës, lirinë e medias dhe mbrojtjet institucionale marrin një rëndësi edhe më të madhe, pasi ato shërbejnë si tregues nëse momenti i anëtarësimit shoqërohet me forcimin e konsiderueshëm të demokracisë.

³⁹ Komisioni Evropian. (2025). [2025 Enlargement Package](#). Komisioni Evropian.

⁴⁰ Komisioni Evropian. (2025). 2025 [Raporti i Progresit 2025 për Shqipërinë](#). Komisioni Evropian.

⁴¹ Këshilli i Bashkimit Evropian. (2025). [Konferenca e 7-të Ndërqeveritare Shqipëri-BE](#). Këshilli i Bashkimit Evropian.

⁴² Vurmo, G. (5 nëntor 2025). [Rruga e Shqipërisë drejt BE-së – Rrugëtimi mes momentit dhe ngërçit](#). Grupi Këshillimor për Politikat Ballkani në Evropë (BiEPAG).

⁴³ Bino, B. (2 janar 2026). [Shqipëria në korsi dhe shpejtë të BE-së, duke përshpejtuar pa u demokratizuar](#). Balkan Insight.

1.3. Qëllimi dhe struktura e raportit

Ky raport vjetor për vitin 2025 ndërtohet mbi kornizën e monitorimit të përcaktuar në *Raportin Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Media dhe Sigurinë e Gazetarëve në Përputhje me Standardet e BE-së*,⁴⁴ ku jepet një vlerësim bazë i problemeve strukturore që ndikojnë në lirinë e medias në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Duke zbatuar të njëjtin instrument analitik dhe qasje metodologjike, në këtë raport evidentohen fushat e progresit, ngërçet dhe regresi gjatë periudhës raportuese 1 janar-31 dhjetor 2025.

Nëpërmjet këtij raporti synohet të ofrojmë një vlerësim të bazuar në evidenca lidhur me gjendjen e gazetarisë dhe lirinë e medias në Shqipëri, me vëmendje të veçantë në reformën institucionale, zbatimin e rekomandimeve të BE-së dhe përvojat e përjetuara nga gazetarët. Një objektiv kryesor i këtij raporti është vlerësimi i përafrimit të Shqipërisë me standardet evropiane, përfshirë këtu angazhimet që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE, Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyeni për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike.

Struktura e raportit e pasqyron këtë fokus të dyfishtë. Së pari, ai e vendos lirinë e medias brenda kuadrit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, më pas vlerëson progresin në masa specifike të planit dhe së fundmi përshkruan gjetjet sasiore nga perceptimet dhe përvojat e gazetarëve. Në kreun përmbyllës jepen rekomandime të posaçme që synojnë forcimin e llogaridhënies institucionale, garancive ligjore dhe kushteve profesionale për gazetarët në Shqipëri.

⁴⁴ Canga, E. & Xhaferaj, O. (24 shkurt 2025). [Raporti Vjetor: Ndjekja e progresit të Shqipërisë në lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në përputhje me standardet e BE-së](#). SCiDEV & BIRN Albania.

2. METODOLOGJIA

2.1. Qasja

Në këtë raport përdoret një qasje me metoda të përziera për të monitoruar në mënyrë sistematike progresin e Shqipërisë në lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në përputhje me rekomandimet e BE-së. Raporti mat dhe analizon edhe perceptimet dhe përvojat e gazetarëve duke dhënë një pamje më të rafinuar të mjedisit mediatik dhe duke nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për reforma. Me anë të ndërthurjes së metodave sasiore dhe cilësore të hulumtimit, raporti ofron një bazë të fortë për vlerësimin e përparimit të vendit dhe sfidave aktuale me të cilat përballet ai.

Për këtë raport janë konsultuar burimet ekzistuese të të dhënave dhe raportet mbi lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, duke u mbështetur tek ato dhe duke ofruar plotësimin e analizave dhe të dhënave të tyre. Ndër dokumentet kryesore të konsultuara janë raportet e pavarura si: (i) Raporti i pluralizmit të medias, Treguesit për Lirinë e Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve, Raporti i Monitorimit të të Drejtave Digjitale; (ii) raportet vjetore të institucioneve publike dhe planet e veprimit; (iii) Raporti Vjetor i BE-së, Raporti për Shtetin e së Drejtës i BE-së; (iv) publikime të tjera përkatëse.

2.2. Hartimi dhe kampioni i sondazhit

Hartimi i raportit përqendrohej në dy objektiva thelbësorë: së pari, ndjekja e progresit të Shqipërisë në zbatimin e rekomandimeve të BE-së për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve; dhe, së dyti, analizimi i përvojave të profesionistëve të medias në vend. Për të arritur këto qëllime, për këtë raport u përdor një metodologji sasiore, duke u përqendruar në mbledhjen e të dhënave demografike dhe profesionale nga gazetarët në të gjithë Shqipërinë. Në total morën pjesë në sondazh 106 profesionistë të medias, sondazh që u administrua gjatë periudhës qershor-gusht 2025, duke mbledhur perceptimet e tyre mbi lirinë e shtypit, problemet për sigurinë dhe kushtet e punës.

Në kampionin e sondazhit bënin pjesë të anketuar nga role të ndryshme profesionale, me vite përvojë të ndryshme, nivel arsimor të ndryshëm dhe nga disa lloje mediash, duke bërë të mundur analizimin e tendencave nga grupe të ndryshme demografike dhe profesionale.

Nga 106 gazetarë të anketuar, 54.7% ishin femra dhe 45.3% meshkuj. Nga analiza e moshës së të anketuarve evidentohet se 41.5% ishin të moshës 25-35 vjeç, ndjekur nga 29.2% të grupmoshës 35-44 vjeç. Të anketuarit e moshës nën 25 vjeç dhe ata të moshës 45-54 vjeç përfaqësonin secili 14.2% të kampionit. Vetëm 0.9% e të anketuarve ishin të moshës 55-64 vjeç.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 43.4%, raportuan se kishin më shumë se 10 vjet përvojë në gazetari. Pjesa e dytë më e madhe e të anketuarve, 22.6%, përbëhet nga ata me 4-6 vjet përvojë. Të anketuarit me 7-10 vjet përvojë përbëjnë 16% të të anketuarve, të ndjekur nga ata me 1-3 vjet përvojë me 11.3%. Vetëm 6.6% e të anketuarve raportuan se kishin më pak se 1 vit përvojë në gazetari.

Figura 1: Profili i të anketuarve sipas gjinisë




Figura 2: Profili i të anketuarve sipas grupmoshës






Figura 3: Profili i të anketuarve sipas përvojës në gazetari




Për sa i përket roleve në punë, më shumë se gjysma e të anketuarve, 63%, deklaruan se ishin gazetarë, të ndjekur nga 9.4% që punonin si kryeredaktorë, 9.4% si gazetarë të pavarur dhe 6.6% redaktorë. Pjesa tjetër e të anketuarve punonin role të tjera në sektorin e medias.

Figura 4: Profili i të anketuarve sipas rolit në punë



Një përqindje e madhe e të anketuarve (62.3%) raportuan se punonin në televizion, ndjekur nga 26.4% që ishin të punësuar në mediat online. Pjesa tjetër punonin në shtypin e shkruar dhe në multimedia.

Figura 5: Profili i të anketuarve sipas llojit të medias ku punojnë




Pjesa më e madhe e të anketuarve, 79.2%, punonin për media private, ndërkohë që pjesa tjetër ishin të punësuar nga OJQ, 17.9%, dhe media publike, 2.8%.

Figura 6: Profili i të anketuarve sipas financimit të mediave ku punojnë



Rreth 66% e të anketuarve thanë se ishin me diplomë master si nivelin e tyre më të lartë arsimor, të ndjekur nga 30.19% që ishin me diplomë bachelor. Një përqindje e vogël, 2.83%, deklaruan se ishin me doktoraturë, ndërsa vetëm 0.94% thanë se kishin diplomë të shkollës së mesme për sa i përket nivelit më të lartë arsimor që kishin.

Figura 7: Profili i të anketuarve sipas nivelit arsimor më të lartë



Përveç kësaj, gjatë muajit shtator 2025 u bënë kërkesa për të drejtë informimi në 10 institucione për të mbledhur të dhëna dhe dokumente zyrtare lidhur me rregullimin e medias, transparencën dhe incidentet që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve në disa muaj. Në raport përfshihen kontribute dhe një përmbledhje e diskutimeve nga tryeza e rrumbullakët e organizuar në 2025 lidhur me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Këto diskutime ofruan të dhëna të tjera cilësore dhe perspektiva të aktorëve të sektorit.

2.3. Avantazhet dhe kufizimet

Nëpërmjet qasjes së metodave të përziera që u përdorën në këtë raport u bë i mundur një vlerësim rigoroz i progresit të Shqipërisë në vitin 2025 drejt përmbushjes së rekomandimeve të BE-së në lidhje me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Nga kombinimi i burimeve dytësore, si raportet dhe dokumentet, sondazhi me gazetarët, intervistat informuese me aktorët e interesit dhe kërkesat për të drejtë informimi për institucionet publike u bë triangulimi i gjetjeve, duke bërë të mundur të kuptohen sa më mirë sfidat strukturore dhe përvojat individuale. Raporti është i rëndësishëm për procesin në vazhdim të anëtarësimit evropian të Shqipërisë.

Megjithatë, raporti nuk është pa kufizime. Varësia te të dhënat e vetë-raportuara nga sondazhi mund të sjellë paragjykime të bazuara në përvojat e perceptuara personale. Për më tepër, ndonëse të vlefshme, kërkesat për informacion sipas të drejtës për informim hasën në përgjigje të kufizuar nga ana e institucioneve dhe në cilësi jo shumë të kënaqshme të informacionit të dhënë. Pavarësisht këtyre kufizimeve, raporti ofron një kornizë të dobishme për monitorimin e progresit dhe identifikimin e përparësive që mund të përkthehen në veprime për rritjen e lirisë së medias dhe sigurinë e gazetarëve.

3. MASAT E UDHËRRËFYESIT PËR SHTETIN E SË DREJTËS – NDJEKJA E PROGRESIT NË 2025

Në këtë kapitull trajtohet niveli i progresit të arritur në vitin 2025 për secilën nga masat e përcaktuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, të miratuar në vitin 2023. Informacioni i paraqitur këtu bazohet te të dhënat e përfthuara nga analiza e dokumenteve, përgjigjet e dhëna nga institucionet sipas të drejtës për informim dhe nga përgjigjet e sondazhit.

3.1. Përqendrimi i pronësisë së mediave dhe transparencës

Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës e përcakton përqendrimin e tregut të medias dhe transparencën e pronësisë si çështje madhore për shtetin e së drejtës dhe institucionet demokratike në kuadër të lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të medias. Udhërrëfyesi thekson se transparencë e pronësisë së medias, publikimi i pronarit përfitues, efektiviteti i sistemit rregullator dhe mbrojtja kundër ndikimit të padrejtë, përfshirë transparencën e reklamave shtetërore dhe financimit publik, janë masa që përforcojnë reciprokisht njëra-tjetrën.⁴⁵ Udhërrëfyesi parashikon monitorim edhe më të madh të sistemit të pronësisë përfituese brenda vitit 2025, zbatim sistematik rregullator duke filluar që nga viti 2025 e më tej dhe masa që trajtojnë rreziqet e përqendrimit të tregut. Ky kuadër politikash është në përputhje me standardet evropiane të reflektuara në Aktin Evropian të Lirisë së Medias (EMFA), akt që trajton transparencën, mbrojtjet e përqendrimit dhe rregullat e reklamave shtetërore si komponentë të ndërlidhur të mbrojtjes së pluralizmit të medias.

Në vitin 2024, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) miratoi Rregulloren Nr. 40 ku përcaktohen kriteret dhe procedurat për shqyrtimin e ndryshimeve të pronësisë dhe forcimin e transparencës së të dhënave të pronësisë për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA).⁴⁶ Rregullorja

⁴⁵ Këshilli i Ministrave. (2023). [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#).

⁴⁶ Autoriteti i Mediave Audiovizive. (26 prill 2024). [Vendimi Nr. 40: Rregullore për ndryshimet e pronësisë](#).

urdhëron publikimin e strukturës pronësore dhe parashikon shqyrtimin e ndryshimeve në aksione dhe kontrollin e tyre. Sipas komunikimeve publike dhe përgjigjeve të AMA-s ndaj kërkesës për të drejtë informimi, njoftimet e ndryshimeve të pronësisë përpunohen sipas këtij kuadri, të dhënat e pronarit përfitues verifikohen me regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit ndërkohë që në vitin 2025 u dhanë miratime zyrtare për ristrukturimin e pronësisë. AMA administron dhe ka publikuar një bazë të dhënash të transparencës së pronësisë për operatorët audiovizivë të licencuar⁴⁷ dhe publikon buletine periodike që përmbajnë të dhëna përkatëse të pronësisë dhe ato financiare.⁴⁸ Këta hapa tregojnë se Shqipëria ka mekanizma operacionalë për të regjistruar, vlerësuar dhe publikuar të dhënat e pronësisë për operatorët e licencuar audiovizivë.

Gjithsesi, në vitin 2025 nuk u prezantuan mekanizma të rinj strukturorë të kontrollit të përqendrimit të pronësisë. Informacioni i bërë publik nuk tregon ekzistencën e kufizimeve detyruese lidhur me pronësinë përtej sektorit të medias, pragun e shtrirjes së audiencës ose një testi operacional të pluralizmit të pronësisë, test që duhet të jetë në gjendje të nisë një kontroll të zgjeruar në rastet e dominimit të tregut. Në vitin 2025 nuk u publikua asnjë vlerësim i përditësuar i përqendrimit të pronësisë dhe as të dhëna të konsoliduara të tregut përtej sektorit të medias. Mungesa e treguesve gjithëpërfshirës të përditësuar rregullisht lidhur me tregun kufizon aftësinë për të vlerësuar tendencat e pluralizmit të pronësisë në kohë reale.

Monitorimi i pronësisë përfituese në vitin 2025 duket se mbetet kryesisht i bazuar në përmbushjen e detyrimeve dhe i varur nga zbulimi dhe verifikimi i mirëfilltë me regjistrat. Dokumentacioni i bërë publik nuk tregon publikimin e nivelit të përmbushjes së detyrimeve, auditimet hetimore ose sanksionet që lidhen posaçërisht me shkeljet e transparencës së pronësisë. Edhe pse ka mekanizma proceduralë, evidencat lidhur me shtrirjen e mëtejshme të monitorimit, siç parashikohet në Udhërrëfyes, mbeten të kufizuara në domenin publik.

Për më tepër, transparenca e pronësisë mbetet e kufizuar vetëm te sektori i mediave. Regjimi ekzistues i publikimit të pronësisë zbatohet kryesisht për operatorët e licencuar audiovizivë, ndërsa mediat online dhe ato digjitale nuk janë subjekt i detyrimeve të tilla për transparencën e pronësisë. Në vlerësimet e pavarura theksohet se ekosistemi mediatik mbetet pjesërisht informal

⁴⁷ Shih [këtu](#).

⁴⁸ Shih [këtu](#).

dhe i fragmentuar, ku ka shumë pak të dhëna të besueshme dhe të konsoliduara lidhur me tregun.⁴⁹ Ky fragmentim kufizon vlerësimin gjithëpërfshirës të përqendrimit të pronësisë në mjediset e konvergjuara të medias.

Treguesit e përqendrimit strukturor mbeten të lartë.⁵⁰ Informacioni i bërë publik nuk tregon se kufizimet detyruese të pronësisë përtej sektorit të medias, kufizimet për shtrirjen e audiencës ose testet sistematike të pluralizmit të jenë aktualisht funksionale si instrumente të zbatueshëm, të aftë për të kufizuar drejtpërsëdrejti pozicionet dominuese. Prandaj, kuadri rregullator është më i fortë në publikimin e pronësisë sipas procedurave sesa në garancitë strukturore të pluralizmit.

Publikimi formal i strukturave pronësore, edhe kur bëhet publik dhe në përputhje me procedurat, nuk garanton në vetvete transparencën e influencave. Ndonëse regjistrat e pronësisë mund të identifikojnë pronarët ligjorë të aksioneve dhe pronarët përfitues të deklaruar, ato nuk evidentojnë dot rrjetin e gjerë të marrëdhënieve nëpërmjet të cilave ushtrohet kontrolli ose ndikimi. Në tregje shumë të përqendruara dhe të ndërlidhura ekonomisht si në Shqipëri,⁵¹ ndikimi mund të ushtrohet përmes interesave të aktorëve të lidhur, marrëdhënieve informale, lidhjeve familjare ose strukturave ndërsektoriale të biznesit që nuk janë drejtpërsëdrejti të evidentueshme në dosjet e korporatave. Kompanitë mediatike janë të integruara edhe në sektorë të rregulluar, ku varësitë tregtare dhe ekspozimi ndaj prokurimit publik ose marrëveshjet e koncesioneve krijojnë stimuj strukturorë që ndikojnë në pavarësinë editoriale.⁵²

Për më tepër, ndikimi financiar mund të ushtrohet në mënyrë të tërthortë përmes kontratave shtetërore, ndarjeve preferenciale të reklamave, marrëveshjeve të nënkontraktimit ose formave të tjera të shpërndarjes së burimeve publike që nuk shfaqen te të dhënat zyrtare të pronarëve të mediave.⁵³ Në vlerësimin e OSBE-së për vitin 2025 theksohet se sistemet që varen kryesisht te

⁴⁹ Dragomir, M. (2025). [Avancimi i reformës së transparencës së pronësisë së medias në Shqipëri: Analiza e boshllëqeve, përputhja me standardet dhe praktikat e mira evropiane dhe ndërkombëtare, dhe një plan praktik veprimi](#). Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

⁵⁰ Voko, K. dhe Likmeta, B. (2025). [Raporti për Pluralizmin e Mediave: Profili i vendit: Shqipëria](#). Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias, Instituti i Universitetit Evropian.

⁵¹ Londo, I. (2025). [Ndryshon peizazhi mediatik, problemet mbeten po ato. E ardhmja e medias në Shqipëri](#). Projekti “E ardhmja e medias”.

⁵² Karaj, V. (12 gusht 2025). [Si ‘përfitimet strategjike’ nga qeveria po rrezikojnë lirinë e medias në Shqipëri](#). Reporter.

⁵³ Voko, K. dhe Likmeta, B. (2025). [Raporti për Pluralizmin e Mediave: Profili i vendit: Shqipëria](#). Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias, Instituti i Universitetit Evropian.

vetë-raportimi dhe mekanizma të fragmentuar për mbikëqyrjen rrezikojnë të anashkalojnë lidhjet komplekse të pronësisë dhe kanalet indirekte të ndikimit.⁵⁴ Në këtë kontekst, transparencë që kufizohet vetëm me publikimin formal të pronarëve dhe aksionerëve mund të ofrojë informacionin e nevojshëm, por mbetet e pamjaftueshme për të identifikuar plotësisht dhe trajtuar rreziqet e përqendrimit, kapjes ose ndikimit të padrejtë në sektorin e medias.

3.2. Matja transparente e audiencës

Brenda kuadrit më të gjerë të transparencës së tregut mediatik dhe garancive të pluralizmit, krijimi i një sistemi transparent të matjes së audiencës përbën një reformë qendrore strukturore. Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës për Shqipërinë e konsideron matjen e audiencës si pjesë të arkitekturës së transparencës të nevojshme për të garantuar konkurrencë të drejtë, shpërndarje objektive të reklamave publike dhe përmirësim të mbikëqyrjes rregullatore.⁵⁵ Në përputhje me standardet evropiane, përfshirë këtu logjikën ku bazohet EMFA, të dhënat e besueshme dhe të verifikuara në mënyrë të pavarur të audiencës janë me rëndësi të madhe jo vetëm për funksionimin e tregut, por edhe për mbrojtjen nga favorizimi dhe ndikimi i padrejtë.

Në vitin 2024, AMA nisi një proces të strukturuar reformash që synonte adresimin e boshllëqeve të vjetra në matjen e audiencës. Pas konsultimeve me ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive dhe aktorët e interesuara të tregut të reklamave, në korrik 2024 u ra dakord për një Komitet të Përbashkët të Industrisë (KPI), i cili u regjistrua zyrtarisht si një entitet i pavarur ligjor në shtator 2025. Në KIP bëjnë pjesë përfaqësues të transmetuesve kombëtarë dhe rajonalë, transmetuesi publik (RTSH) dhe agjenci marketingu. Në të njëjtën kohë, AMA përgatiti projekt-amendamente për Ligjin nr. 97/2013 duke futur konceptin e “matjes së audiencës” në kuadrin ligjor, amendamente që janë aktualisht në proces konsultimi publik.⁵⁶

⁵⁴ Dragomir, M. (2025). [Avancimi i reformës së transparencës së pronësisë së medias në Shqipëri: Analiza e boshllëqeve, përputhja me standardet dhe praktikën e mira evropiane dhe ndërkombëtare, dhe një plan praktik veprimi](#). Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

⁵⁵ Këshilli i Ministrave. (2023). [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#).

⁵⁶ Përgjigja e AMA-s ndaj kërkesës për të drejtë informimi, tetor 2025.

Këta hapa janë tregues i përparimit të prekshëm institucional. Nëpërmjet krijimit dhe regjistrimit ligjor të KIP-it krijohet një strukturë formale qeverisjeje për matjen e audiencës, e cila më parë kishte qenë e fragmentuar ose e kontestuar. Po ashtu, reforma sinjalizon përafrimin me praktikën evropiane, ku organet e udhëhequra nga sektori shpesh mbikëqyrin sistemet e matjes nën mbikëqyrje rregullatore.

Gjithsesi, që nga viti 2025, reforma mbetet në një fazë institucionale e përgatitore. Dokumentacioni i bërë publik nuk tregon të jetë publikuar ndonjë metodologji matjeje e unifikuar dhe e miratuar zyrtarisht. Nga ana tjetër, nuk ka prova të dhënash operative të audiencës të prodhuara sipas kuadrit të ri të KIP-it dhe as nuk ka dokumentacion të marrëveshjeve të auditimit të pavarur, për procedura të vleftësimit ose proceseve transparente të përzgjedhjes së enteve që realizojnë matjen e audiencës. Pa këta elementë ende nuk mund të kemi një vlerësim të qëndrueshmërisë, besueshmërisë dhe krahasueshmërisë së sistemit.

Për më tepër, mbetet e paqartë nëse rezultatet e matjes së audiencës, pasi të jenë funksionale, do të mund të integrohen zyrtarisht në mekanizmat mbikëqyrës rregullatorë, përfshirë këtu vlerësimin e dominimit të tregut ose ndarjen e reklamave shtetërore. Mungesa e një lidhjeje ligjorisht të detyrueshme mes rezultateve të matjes dhe shpërndarjes së reklamave publike kufizon ndikimin e menjëhershëm të reformës në trajtimin e favorizimit apo për garantimin e konkurrencës së drejtë.

Modeli i qeverisjes së KIP-it është i bazuar në sektor, gjë që është në përputhje me modelet evropiane, por kërkon garanci të forta për të garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë. Zbatimi efektiv do të varet nga rregullat e qarta lidhur me konfliktin e interesit, standardet transparente për metodologjinë dhe mekanizmat e pavarur të verifikimit. Dokumentacioni i shqyrtuar, i aksesueshëm publikisht, ende nuk ofron informacion të detajuar mbi këto garanci.

3.3. Dialogu i strukturuar për lirinë e medias

Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës për Shqipërinë njeh rëndësinë e dialogut të strukturuar dhe angazhimit të koordinuar institucional në trajtimin e sfidave që lidhen me lirinë e shprehjes,

pluralizmin e medias, pavarësinë e institucioneve rregullatore dhe sigurinë e gazetarëve.⁵⁷ Brenda këtij kuadri, konsultimi dhe bashkëpunimi me shumë aktorë të sistemit trajtohen si mekanizma mundësues për avancimin e reformave në përputhje me standardet evropiane dhe angazhimet e Shqipërisë për integrimin në BE. Në vitin 2025, u vu re përparim në këtë drejtim me funksionimin e platformës së dialogut të strukturuar për median.

Në janar 2025, në kuadër të një nisme të përbashkët të mbështetur nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës, u hap zyrtarisht “Dialogu i Hapur mbi Lirinë e Shprehjes”, i cili shërbeu si organizatori institucional i platformës së strukturuar.⁵⁸ Gjatë periudhës janar-qershor 2025, u mbajtën nëntë takime tematike, ku u bënë bashkë përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, organizata mediatike, shoqata të gazetarëve dhe qarqeve akademike me përfaqësues nga institucionet ekzekutive, përfshirë këtu Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin; rregullatorin e medias (AMA), transmetuesin publik RTSH; përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, Inspektorati i Punës dhe institucione e aktorë të tjerë të interesuar.

Objekti tematik ishte tregues i natyrës së ndërlidhur të sfidave të qeverisjes së mediave. Në diskutime u trajtuan siguria dhe kushtet e punës së gazetarëve, mekanizmat e vetërregullimit, aksesit në informacion, pluralizmi i medias, përfshirë këtu transparencën dhe përqendrimin e pronësisë, dhe pavarësia institucionale e AMA-s dhe RTSH-së. U aplikua një metodologji e strukturuar, ku bën pjesë përgatitja e dokumenteve bazë, kontributet e ekspertëve dhe hartimi i rekomandimeve që synojnë konsolidimin e fushave të marrëveshjes.⁵⁹ Faza e parë kulmoi me një konferencë plenare të nivelit të lartë e mbajtur më 30 qershor 2025, ku u prezantuan dhe u debatuan projekt-rekomandimet e përgatitura nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.⁶⁰

⁵⁷ Këshilli i Ministrave. (2023). [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#).

⁵⁸ Këshilli i Evropës. (2025). [Promovimi i lirisë së shprehjes në Shqipëri nëpërmjet dialogut të hapur](#). Këshilli i Evropës.

⁵⁹ Dokumentet mbështetëse dhe rekomandimet e zhvilluara nga platforma e medias së strukturuar janë vënë në dispozicion nga Këshilli i Evropës në [këtë link](#).

⁶⁰ Këshilli i Evropës. (30 qershor 2025). [Aktorët dhe institucionet kryesore të medias bashkohen për të çuar përpara lirinë e shprehjes dhe reformat e medias](#). Këshilli i Evropës.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025, procesi u zhvendos drejt angazhimit legjislativ. Në periudhën shtator-dhjetor 2025 u organizuan dy takime të tjera me pjesëmarrjen e deputetëve. Një takim u përqendrua në ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, përfshirë dispozitat që lidhen me shpifjen dhe fyerjen, ndërsa tjetri trajtoi përqendrimin e medias, transparencën e pronësisë dhe pavarësinë e institucioneve rregullatore.⁶¹ Në tetor 2025, rezultatet e platformës u transmetuan zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë në Parlament. Në dhjetor 2025, Kuvendit iu paraqit një nismë legislative e Kryetares së Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik ku pasqyroheshin elementë të dialogut, përfshirë këtu propozimet që lidhen me shpifjen si vepër penale. Kjo nismë u publikua për konsultim publik,⁶² pa asnjë ndryshim përfundimtar ligjor të miratuar deri në fund të vitit.

Edhe pse procesi i dialogut të strukturuar në vitin 2025 përbën një hap konstruktiv drejt reformës së koordinuar të medias, gjatë vlerësimit, disa aspekte meritojnë më shumë vëmendje. Çështja më e rëndësishme ka të bëjë me mungesën e një kuadri gjurmueshmërie të përcaktuar qartë që lidh rekomandimet e Platformës me veprimet e mëpasshme të ndërmarrë nga qeveria dhe Parlamenti. Ndonëse nuk pritet të miratohen të gjitha rekomandimet e një platforme me shumë aktorë, rritja e transparencës lidhur me propozimet që u pranuan, u modifikuan apo që nuk u morën parasysh dhe arsyet për vendime të tilla do të forconin llogaridhënien, do të garantonin një angazhim domethënës të aktorëve të interesuar, do të forconin krijimin e besimit dhe do të zvogëlonin rrezikun që konsultimi i strukturuar të perceptohet si më shumë si procedurë dhe jo si me ndikim thelbësor.

Përveç kësaj, ndërkohë që pjesëmarrja në nivel teknik nga institucionet qeveritare ishte e qëndrueshme dhe substanciale, angazhimi i qëndrueshëm në nivel politik dukej më i kufizuar dhe ishte përqendruar kryesisht në fazat e mëvonshme të procesit. Pronësia më e gjerë politike gjatë gjithë ciklit të dialogut do të bënte të mundur vazhdimësinë dhe do të rriste gjasat që propozimet për reforma të zbatohen në mënyrë koherente. Afatet kohore të konsultimit në faza të caktuara të procesit ishin relativisht të shkurtra. Për më tepër, Platforma nuk u rimblodh rregullisht në përgjigje të zhvillimeve të mëdha mediatike gjatë verës së vitit 2025.⁶³

⁶¹ SCiDEV. (25 shtator 2025). [SCiDEV prezanton analizën mbi projekt-Kodin Penal në Grupin e 10-të të Punës për Lirinë e Shprehjes dhe Sigurinë e Gazetarëve](#).

⁶² SCiDEV. (15 dhjetor 2025). [Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik - Konsultimi me Shoqërinë Civile](#). Përmbledhje e pezazhit për mediat.

⁶³ Shih Reagimi i shoqërisë civile mbi [projektkodin e ri penal](#) dhe situatën lidhur me [Focus Media Group](#). Këshilli i Evropës Platform on

3.4. Siguria e gazetarëve

Siguria e gazetarëve në Shqipëri vazhdon të përcaktohet më pak nga incidente të izoluara dhe më shumë nga kushtet strukturore që rrisin cenueshmërinë. Gazetarët dhe profesionistët e medias punojnë në një mjedis të karakterizuar nga kushte të pasigurta pune, varësi ekonomike, paqartësi politiko-ekonomike dhe akses i kufizuar tek institucionet, të cilat të marra së bashku i bëjnë gazetarët më të rrezikuar ndaj presionit, ngacmimit ose kanosjes.⁶⁴ Këto presione amplifikohen në sferën digjitale përmes kërcënimeve online dhe fushatave të shpifjes.

Sipas monitorimit nga Rrjeti SafeJournalists, gjatë vitit 2025⁶⁵ u regjistruan 42 raste shkeljesh kundër gazetarëve, përfshirë këtu kërcënime, kanosje, ngacmim online dhe forma të tjera presioni të lidhura me aktivitetin e gazetarëve. Qasja e monitorimit të SafeJournalists thekson se rastet individuale duhet të kuptohen brenda këtij konteksti më të gjerë strukturor, veçanërisht kur vlerësohet hendeuku midis garancive në letër dhe zbatimit praktik të tyre.

Si për krahasim, të dhënat zyrtare nga institucionet e zbatimit të ligjit pasqyrojnë një numër më të vogël të rasteve të regjistruara zyrtarisht. Gjatë periudhës janar-tetor 2025, Policia e Shtetit regjistroi 18 raste që kishin të bënin me gazetarë, përfshirë këtu edhe gjashtë denoncime për kërcënime për jetën ose dëmtime trupore dhe 12 që kanë të bëjnë me forma të tjera kërcënimesh ose ngacmimesh.⁶⁶ Nga Prokuroria e Përgjithshme raportohet se gjatë periudhës janar-shtator 2025 ishin në shqyrtim nëntë procedura që kishin të bënin me gazetarë, ku katër ishin denoncime të reja të bëra gjatë asaj periudhe, shumica e të cilave mbeten në fazën e verifikimit paraprak.⁶⁷ Mospërputhja me shifrat lidhur me shkeljet e dokumentuara në mënyrë të pavarur dhe rastet e regjistruara zyrtarisht tregon se ka nën-raportim dhe jo të gjithë incidentet arrijnë në fazat e hetimit.

Safety of Journalists [Alert](#) on penal code and [Alert](#) on Focus Media Group.

⁶⁴ Rrjeti SafeJournalists [Buletinet mujore janar-dhjetor 2025](#).

⁶⁵ Rrjeti SafeJournalists [data baza e incidenteve](#).


⁶⁶ Përgjigje e Policisë së Shtetit për një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025.

⁶⁷ Përgjigje e Prokurorisë së Përgjithshme për një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025.

3.4.1. Perceptimet e përgjithshme për sigurinë dhe lirinë


Të dhënat e sondazhit të bazuar në perceptime për vitin 2025 tregojnë se shqetësimet lidhur me sigurinë e gazetarëve mbeten të pandryshuara mes një klime më të gjerë të përkeqësimit të kushteve profesionale. Kur iu kërkua të vlerësonin ndryshimet krahasuar me vitin e kaluar, 36.8% e të anketuarve raportuan se siguria e gazetarëve ishte përkeqësuar (16.0% rënie e ndjeshme dhe 20.8% rënie e moderuar), ndërsa 17.0% raportuan përmirësim (2.8% i ndjeshëm dhe 14.2% i moderuar) dhe 44.3% raportuan se nuk kishte patur asnjë ndryshim. Edhe pse kemi një përqindje më të ulët që raportojnë përkeqësim krahasuar me vitin 2024 (54.7%), më shumë se një e treta e të anketuarve vazhdojnë të perceptojnë një përkeqësim të kushteve të sigurisë. Kjo sugjeron se ndonëse perceptimet për sigurinë mund të jenë stabilizuar disi në krahasim me vitin e kaluar, një pjesë e konsiderueshme e gazetarëve vazhdojnë të përjetojnë ose perceptojnë dobësi në mjedisin e tyre profesional, duke theksuar se shqetësimet themelore strukturore mbeten ende të pazgjidhura.

Figura 8: Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion krahasuar me një vit më parë




Perceptimet për rënien e sigurisë së gazetarëve janë edhe më të theksuara kur analizohen lidhur me kushtet që i mundësojnë ato. Në vitin 2025, 64.2% e të anketuarve deklaruan se liria e shprehjes ishte përkeqësuar (34.0% rënie e ndjeshme dhe 30.2% rënie e moderuar), krahasuar me 61.2% në vitin 2024. Aksesit në informacion u perceptua se ishte përkeqësuar nga 50.0% e të anketuarve (31.1% rënie e ndjeshme dhe 18.9% rënie e moderuar), paksa më e ulët se norma 54.3% e regjistruar në vitin 2024. Kushtet e punës u raportuan të ishin përkeqësuar për 36.8% në vitin 2025 (18.9% rënie e konsiderueshme dhe 17.9% rënie e moderuar), krahasuar me 42.4% në vitin 2024. Këto shifra tregojnë se edhe pse perceptimet e sigurisë fizike tregojnë njëfarë përmirësimi relativ krahasuar me vitin e kaluar, kushtet më të gjera strukturore që ndikojnë në gazetari mbeten vazhdimisht negative.

Figura 9: “Si do t’i vlerësonit ndryshimet në aspektet e mëposhtme të gazetarisë në Shqipëri gjatë vitit të kaluar?”
Siguria e gazetarit, kushtet e punës, liria e shprehjes dhe aksesit në informacion, të dhënat e vitit 2025 krahasuar me ato të vitit 2024



Dallimet me bazë gjinore janë më të kufizuara. Burrat kanë disi më shumë gjasa krahasuar me gratë të perceptojnë një përkeqësim në lirinë e shprehjes (68.8% e burrave krahasuar me 60.3% të grave raportojnë rënie të moderuar ose të ndjeshme). Në fushat e tjera, perceptimet midis burrave dhe grave janë përgjithësisht të krahasueshme.


Figura 10: Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion krahasuar me një vit më parë



Të dhënat nxjerrin në pah dallime të mëdha sipas rolit të të anketuarit. Redaktorët raportojnë nivelet më të larta të përkeqësimit të lirisë së shprehjes, me 41.2% që tregojnë rënie të ndjeshme dhe 29.4% rënie të moderuar (70.6% të marrë së bashku), krahasuar me 64.1% mes reporterëve (32.8% rënie e ndjeshme, 31.3% e moderuar) dhe 59.1% midis gazetarëve të tjerë (31.8% rënie e ndjeshme, 27.3% e moderuar). Lidhur me sigurinë e gazetarëve, 47.0% e redaktorëve (17.6% e ndjeshme, 29.4% e moderuar) perceptojnë një rënie, krahasuar me 35.8% të reporterëve (16.4% e ndjeshme, 19.4% e moderuar) dhe 31.8% të gazetarëve të tjerë (13.6% e ndjeshme, 18.2% e moderuar). Për aksesin në informacion, 76.5% e redaktorëve (35.3% e ndjeshme,

41.2% e moderuar) raportojnë përkeqësim, krahasuar me 46.2% të reporterëve dhe 40.9% të gazetarëve të tjerë. Këto dallime sipas roleve në profesion sugjerojnë se gazetarët në pozicione vendimmarrëse editoriale perceptojnë kufizime më të mëdha, veçanërisht në fushat e lidhura drejtpërdrejt me pavarësinë editoriale dhe aksesin në institucione.

Figura 11: Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve, kushteve të punës, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion krahasuar me një vit më parë, sipas rolit të të anketuarit në gazetari




Të marra së bashku, evidencat e vitit 2025 tregojnë një realitet të dyfishtë. Nga njëra anë, Shqipëria ka krijuar mekanizma institucionalë zyrtarë për regjistrimin dhe hetimin e sulmeve kundër gazetarëve; nga ana tjetër, perceptimet lidhur me nivelin e sigurisë tregojnë një rënie krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, nivelet e larta të kufizimeve të raportuara, perceptimet e vazhdueshme të rënies së lirisë së shprehjes dhe qasjes në informacion, si dhe dobësitë strukturore në kushtet e punës sugjerojnë se sfidat e sigurisë mbeten të lidhura ngushtë me qeverisjen në përgjithësi dhe me kushtet e tregut. Mbetet detyrë parësore garantimi që kuadri formal i garancive të përkthehet në përmirësime të prekshme në pavarësinë profesionale dhe sigurinë e gazetarëve.

3.4.2. Përvoja me censurën mbi lirinë e raportimit


Të dhënat e sondazhit tregojnë se kufizimet e perceptuara në raportim mbeten të përhapura edhe në vitin 2025 dhe kryesisht të pandryshuara krahasuar me vitin e kaluar. Vetëm 9.4% e të anketuarve raportojnë se kanë qenë vazhdimisht në gjendje të raportojnë lirisht pa frikë nga hakmarrja ose censura. Në krahun tjetër, 40.6% raportojnë se me raste ndihen të kufizuar, 16.0% raportojnë shqetësime të shpeshta dhe 11.3% deklarojnë se nuk kanë qenë asnjëherë në gjendje të raportojnë lirisht. Në total, rreth 68% e të anketuarve kanë përjetuar një farë kufizimi gjatë vitit të kaluar.

Figura 12: “Gjatë vitit të kaluar, a jeni ndjerë i/e lirë të raportoni për çdo temë pa frikë nga hakmarrja apo censura?”




Të dhënat e ndara tregojnë dallime të mëdha mes grupeve. Të anketuarit burra raportojnë nivele më të larta kufizimi (77.1%) krahasuar me të anketuarat gra (60.3%). Sipas rolit në profesion, reporterët (71.6%) dhe gazetarët e tjerë (72.7%) raportojnë nivele më të larta kufizimi sesa redaktorët (47.1%). Sipas llojit të medias, gazetarët që punojnë në kategoritë “e tjera” të medias raportojnë nivelet më të larta të kufizimit (83.3%), të ndjekur nga gazetarët e televizionit (71.2%), ndërsa gazetarët online raportojnë nivele më të ulëta, por ende të konsiderueshme (53.6%). Edhe përvoja ndikon në perceptime: gazetarët me 4-6 vjet përvojë (70.8%) dhe më shumë se 10 vjet përvojë (71.7%) raportojnë nivele më të larta kufizimi sesa ata me 0-3 vjet përvojë (57.9%). Këto ndryshime tregojnë se kufizimet e perceptuara nuk janë të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë profesionin dhe sugjerojnë për një ballafaqim në nivele të ndryshme me presionin.

Figura 13: Përqindja e të anketuarve që gjatë vitit të kaluar ose “vazhdimisht jam ndjerë e paaftë për të raportuar lirisht për shkak të frikës nga hakmarrja ose censura”, “shpesh përballesh me shqetësime në lidhje me hakmarrjen ose censurën”, ose “ndonjëherë jam ndjerë i/e kufizuar ose kisha frikë nga pasojat për tema të caktuara”



Kufizimet përqendrohen kryesisht në fusha të caktuara tematike. Raportimi mbi korrupsionin madhor identifikohet si i ndjeshëm nga 61.3% e të anketuarve, duke e bërë atë temën më të kufizuar në të gjitha kategoritë. Krimi i organizuar vijon me 34%, me një hendek të theksuar gjinor (52.1% e burrave kundrejt 19.0% të grave që raportojnë kufizime). Mbulimi i korporatave të mëdha dhe praktikave të këqija ekonomike identifikohet si tematikë e kufizuar nga 26.4% e të anketuarve. Këto gjetje tregojnë se kufizimet e perceptuara kanë të bëjnë kryesisht me problematika lidhur me llogaridhënien politike, interesat ekonomike dhe rrjetet kriminale.

Figura 14: Tema ose fusha për të cilat të anketuarit ishin veçanërisht të ndjeshëm ose të kufizuar për të raportuar gjatë vitit të kaluar (Sipas gjinisë së të anketuarit)




Më shumë se një përgjigje

Të dhënat tregojnë se kufizimet e perceptuara përqendrohen kryesisht rreth raportimit mbi korrupsionin madhor, i cili identifikohet si i ndjeshëm nga 64.2% e reporterëve, 52.9% e redaktorëve

dhe 59.1% e gazetarëve të tjerë, me nivele të ngjashme të larta në të gjithë grupet sipas viteve të përvojës (duke filluar nga 57.9% në 66.7%) dhe llojet e mediave (57.1% në 66.7%). Krimi i organizuar vijon si tema e dytë më e kufizuar, por me më shumë variacion: 47.4% e gazetarëve me 0-3 vjet përvojë raportojnë kufizime në këtë fushë krahasuar me 23.5%-37.0% mes gazetarëve më me shumë përvojë dhe 42.9% e gazetarëve online raportojnë kufizime krahasuar me 34.8% të gazetarëve televizivë dhe 8.3% midis llojeve të tjera të mediave. Mbulimi i korporatave të mëdha dhe praktikat e këqija ekonomike raportohet si i kufizuar nga 29.9% e reporterëve dhe 35.3% e redaktorëve, krahasuar me 9.1% të gazetarëve të tjerë. Si për krahasim, tema të tilla si diskriminimi, ndryshimet klimatike ose çështjet gjinore raportohen me nivel dukshëm më të ulët kufizimesh.


Figura 15: Tema të ndjeshme ose të kufizuara të identifikuara nga të anketuarit gjatë vitit të kaluar, të kategorizuara sipas rolit, përvojës në media dhe llojit të medias (Më shumë se një përgjigje)



Shpërndarja e përgjigjeve sugjeron se kufizimet e perceptuara përqendrohen kryesisht rreth çështjeve që kanë të bëjnë me korrupsionin, interesat ekonomike dhe krimin e organizuar, që janë fusha që zakonisht lidhen me pushtetin politik, ndikimin financiar dhe rrezikun ligjor.

Në vitin 2025, vetëm 19.8% e të anketuarve raportuan se nuk u është dashur kurrë të braktisin ose të mos e publikojnë një histori për shkak të presionit, censurës, vendimeve editoriale ose vetëcensurës, ndërsa rreth 80% e kanë përjetuar këtë të paktën një herë. Veçanërisht, 22.7% raportuan se e bënin një gjë të tillë shpesh ose shumë shpesh. Dallimet mes gjinive janë të kufizuara, ku përgjigja “kurrë” vihet re më shumë mes grave (22.4%) krahasuar me burrat (16.7%). Këto gjetje tregojnë se kufizimet e perceptuara nuk janë thjesht përshtypje subjektive, por kanë një ndikim të matshëm në raportimet e gazetarëve dhe në informacionin që i vihet në dispozicion publikut.

*Figura 16: “Gjatë vitit të kaluar, a ju është dashur të braktisni/të mos publikoni një lajm ose kronikë për shkak të presioneve, vendimeve editoriale, censurës ose vetëcensurës?”
(Sipas gjinisë)*




Ndryshimet sipas viteve të përvojës dhe llojeve të mediave ku punojnë gazetarët tregojnë nivele të ndryshme përballjeje me presionin, ku gazetarët me më pak përvojë dhe ata që punojnë në mediat online raportojnë për një numër më të madh kufizimesh në fusha të caktuara të ndjeshme. Në të njëjtën kohë, evidentimi i vazhdueshëm i korrupsionit si tema më e kufizuar në pothuajse të gjitha kategoritë tregon një model strukturor dhe jo incidente të izoluar, duke përfunduar kështu vlerësimin se kufizimet e perceptuara janë të brendësura në fusha të caktuara të raportimit me rrezik të lartë dhe jo të shpërndara njëtrajtësisht në të gjithë sektorin e gazetarisë.

3.4.3. Përvojat me sigurinë dhe kërcënimet

Të dhënat e sondazhit për vitin 2025 tregojnë se, ndonëse përhapja në përgjithësi e kërcënimeve dhe kanosjeve mbetet e konsiderueshme, modelet kanë ndryshuar disi krahasuar me vitin e kaluar. Në total, 12.3% e të anketuarve raportojnë se janë sulmuar fizikisht ose janë sulmuar të paktën një herë gjatë punës si gazetarë, krahasuar me 11.5% në vitin 2024, duke reflektuar një rritje të vogël. Si për krahasim, 40.6% raportojnë se kanë përjetuar kërcënime ose kanosje që ka të bëjë me aktivitetin e tyre profesional, ku kemi një rënie modeste krahasuar me 45% në vitin 2024. Kjo sugjeron stabilitet relativ në mjedisin e përgjithshëm të kërcënimeve, pa ndonjë përmirësim të ndjeshëm.


Figura 17:

Përqindja e të anketuarve që janë sulmuar fizikisht ose janë sulmuar gjatë punës si gazetarë në Shqipëri, rezultatet e vitit 2025 krahasuar me ato të vitit 2024




Ndarja sipas kategorive nxjerr në pah një përballje të diferencuar mes grupeve. Burrat raportojnë numër më të madh të sulmeve fizike (18.8%) krahasuar me gratë (6.9%). Reporterët duken më të prekur se redaktorët, pa sulme fizike të raportuara mes redaktorëve të këtij kampi. Gazetarët e televizionit raportojnë se përballen më shumë me sulme fizike ashtu edhe me kërcënime krahasuar me gazetarët online. Sa i përket përvojës, gazetarët me 7-10 vjet përvojë raportojnë incidencë më të lartë të sulmeve fizike, ndonëse ndryshimet mes grupeve sipas viteve në profesion nuk janë mjaftueshëm të qëndrueshme për të krijuar një trend të qartë linear.

Figura 18: Përqindja e të anketuarve që janë sulmuar fizikisht ose janë bërë pre e sulmeve gjatë punës si gazetarë në Shqipëri sipas kategorive




Midis atyre që kanë përjetuar sulme fizike, 76.9% raportojnë sulm fizik, 23.1% raportojnë vandalizëm ose shkatërrim prone dhe 7.7% raportojnë kërcënime verbale gjatë incidenteve. Veçanërisht, një i anketuar raportoi se është sulmuar fizikisht nga oficerët e policisë gjatë kryerjes së raportimit investigativ.

Figura 19: Natyra e sulmeve (Vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)




Ndonëse shumica e të anketuarve (76.9%) raportuan se sulmet nuk e ndryshuan rrënjësisht raportimin e tyre, një përqindje e matshme pohoi për ndryshime në sjellje: 15.4% kërkuar mbështetje ose këshillim, 15.4% morën masa të tjera paraprake sigurie dhe 7.7% shmangën mbulimin e temave të caktuara ose modifikuan qasjen e tyre ndaj raportimit.

Figura 20: “A ndikoi sulmi fizik në raportimin tuaj dhe, nëse po, si?” (Vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)




Të dhënat e sondazhi tregojnë se 40.6% e të anketuarve raportuan se në vitin 2025 kishin përjetuar kërcënime ose kanosje që lidhej me punën e tyre si gazetarë, krahasuar me 45.3% në vitin 2024. Edhe pse kemi një rënie modeste prej rreth pesë pikë përqindjeje, përqindja mbetet e lartë, duke treguar se përballja me kanosjet vazhdon të ndikojë te një segment i konsiderueshëm i profesionit. Përqindja e të anketuarve që raportuan se nuk kishin përjetuar kërcënime mbeti përgjithësisht e qëndrueshme (47.2% në vitin 2025 krahasuar me 46.8% në vitin 2024), ndërkohë që përqindja që preferonte të mos përgjigjej u rrit nga 7.9% në 2024 në 12.3% në 2025, gjë që mund të jetë tregues i ndjeshmërisë në rritje rreth kësaj çështjeje. Të dhënat tregojnë stabilitet relativ në vend të përmirësimit të ndjeshëm për sa i përket kërcënimeve, ku kanosjet mbeten një tipar i vazhdueshëm i kontekstit profesional për gazetarët në Shqipëri.

Figura 21: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose kanosje në lidhje me punën e tyre si gazetarë, rezultate e vitit 2025 krahasuar me ato të vitit 2024



Në Figurën 22 jepet një ndarje e detajuar e gazetarëve që raportuan se në vitin 2025 kishin përjetuar kërcënime ose kanosje. Dallimet sipas gjinive janë të dukshme, ku 45.8% e të anketuarve burra raportuan kërcënime krahasuar me 36.2% të të anketuarve gra. Sipas rolit në gazetari, reporterët duken më të ekspozuar (49.3%), të ndjekur nga gazetarë të tjerë (36.4%), ndërsa redaktorët raportojnë një përballje dukshëm më të vogël me kanosjet (11.8%). Nga ana tjetër, edhe ndarja sipas viteve në punë tregon ndryshime: gazetarët me 7-10 vjet përvojë (47.1%) dhe më shumë se 10 vjet përvojë (47.8%) raportojnë përballje më të madhe sesa ata me 0-3 vjet përvojë (21.1%), duke sugjeruar që profesionistët me karrierë disi dhe shumë të pasur mund të kenë më shumë gjasa të mbulojnë çështje të ndjeshme që tërheqin presion. Edhe dallimet sipas llojit të medias ku punojnë janë të theksuara: 53.0% e gazetarëve që punojnë në televizion raportojnë se kanë marrë kërcënime krahasuar me 25.0% të gazetarëve që punojnë për mediat online dhe vetëm 8.3% të atyre që punojnë në media të tjera. Edhe struktura e pronësisë duket se ka të bëjë me këtë çështje, ku gazetarët në mediat private raportojnë se kanë përjetuar më shumë kërcënime (44.0%) sesa ata në mediat publike (33.3%) ose mediat e OJQ-ve (26.3%).

Figura 22: Përqindja e të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose kanosje në lidhje me punën e tyre si gazetarë, ndarje sipas kategorive




Ndarja sipas kategorive tregon se përballja me kërcënimet është e pabarabartë në të gjithë profesionin dhe është veçanërisht e përqendruar te reporterët, gazetarët e televizionit dhe ata që punojnë në mediat private, duke sugjeruar cenueshmëri të diferencuar të lidhur me rolin, dukshmërinë e platformës dhe kontekstin e pronësisë.

Të dhënat tregojnë se kërcënimet verbale janë forma më e zakonshme e kanosjes, e raportuar nga 72.1% e atyre që kanë përjetuar kërcënime, ku burrat (77.3%) janë më shumë të ekspozuar krahasuar me gratë (66.7%). Më pas vjen ngacmimi online me 46.5% të totalit të të anketuarve, përsëri më shpesh i raportuar nga burrat (54.5%) sesa nga gratë (38.1%). Telefonatat ngacmuese dhe gjuha përçmuese, përfshirë fyerjet, raportohen nga 30.2% e të anketuarve në secilën kategori, edhe pse gratë raportojnë përqindje më të madhe të gjuhës përçmuese (33.3%) krahasuar me burrat (27.3%). Kërcënimet me padi ligjore raportohen nga 27.9% e të anketuarve dhe janë dukshëm më të zakonshme mes burrave (36.4%) sesa grave (19.0%). Nga ana tjetër, kërcënimi me objekt anëtarët e familjes është dukshëm më i shpeshtë mes grave (33.3%) sesa burrave (13.6%), ndërsa presioni ekonomik prek të dy gjinitë në nivele të krahasueshme (20.9% e të anketuarve).


Këto tendenca tregojnë se kërcënimet ndaj gazetarëve janë kryesisht verbale dhe digjitale për nga natyra, ku ka dallime sipas gjinisë për sa i përket mënyrë së përjetimit të kanosjes, gjë që sugjeron se presionet mund të përshtaten në forma të ndryshme në varësi të objektivit.

Figura 23: Lloji i kërcënimeve apo kanosjeve, vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve (Sipas gjinisë)




Mes të anketuarve që kanë përjetuar kërcënime ose kanosje, 41.9% raportuan se janë përballur shpesh me to. Kjo është një gjetje serioze. Për shumë gazetarë, kërcënimet nuk janë incidente të izoluara, por pjesë e rregullt e punës së tyre të përditshme. Në mënyrë të veçantë, mes atyre që janë përballur me kërcënime, gratë raportuan se i kanë përjetuar ato më shpesh sesa burrat.

Figura 24: Shpeshtësia e kërcënimeve dhe kanosjeve të përjetuara sipas gjinisë (Vetëm ata që kanë qenë pre e sulmeve)




Zyrtarët e qeverisë identifikohen si burimi kryesor i kërcënimeve ose kanosjeve (65.1%), të ndjekur nga grupet politike (37.2%), organizatat kriminale (30.2%) dhe pronarët e mediave (25.6%). Po ashtu, mes atyre që raportojnë presion për të ndryshuar, vonuar ose hequr dorë nga raportimet, 61.8% identifikojnë politikanët ose zyrtarët e qeverisë si burimin kryesor, të ndjekur nga drejtuesit e medias dhe interesat e biznesit (secili nga 38.2%). Përqendrimi i presionit që buron nga aktorët politikë dhe institucionalë sugjeron se rreziqet për pavarësinë e gazetarisë nuk kufizohen vetëm me kanosje kriminale, por janë të brendësura në mënyrë të konsiderueshme te strukturat politike dhe qeverisëse. Kjo tendencë tregon se sfidat ndaj lirisë së medias për vitin 2025 janë të ndërthurura ngushtë me asimetritë e pushtetit mes gazetarëve dhe aktorëve shtetërorë ose politikë, duke ngritur shqetësime lidhur me mjedisin e përgjithshëm që bën të mundur raportimin e pavarur.

Figura 25: Burimet kryesore të kërcënimeve apo kanosjes (Vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë)

Të dhënat tregojnë se midis gazetarëve që raportuan se kishin përjetuar presion për të ndryshuar, vonuar ose hequr dorë nga raportimet, lloji më i zakonshëm i presionit ishte presioni i drejtpërdrejtë nga politikanët ose zyrtarët e qeverisë (61.8%). Presioni nga brenda medias ose nga vetë drejtuesit dhe presioni nga interesat e biznesit ose reklamuesit raportohen në nivele të barabarta (38.2% secila), duke treguar se kufizimet editoriale lindin jo vetëm nga jashtë, por edhe brenda strukturave të medias. Presioni nga organizatat kriminale raportohet nga 18.2%, ndërsa kufizimet me afatet kohore janë të papërfillshme (1.8%). Një shpërndarje e tillë sugjeron se presioni politik është forma më dominuese e ndërhyrjes, por edhe presionet nga biznesi dhe ato që vijnë nga brenda medias luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e vendimeve editoriale.


Mbizotërimi i presionit politik, i kombinuar me presione të konsiderueshme nga vetë media dhe biznesi, tregon se kufizimet editoriale janë të pranishme si në dimensionin shtetërorë ashtu edhe atë tregut, duke përkeqësuar cënueshmërinë strukturore të pavarësisë së gazetarëve.

Figura 26: Llojet e presionit të përjetuar nga gazetarët për të ndryshuar, vonuar ose hequr dorë nga raportimi (Vetëm ata që kanë qenë pre e presionit)



Në vitin 2025, 16.4% deklaruan se kërcënimet nuk ndikuan fare në raportimin e tyre, ndërsa 27.3% raportuan vetëcensurë në një masë të vogël dhe 34.5% në një masë të moderuar. Më shqetësuese është se 16.4% raportuan vetëcensurë në një masë të madhe dhe 5.5% në një masë shumë të madhe. Krahasuar me vitin 2024, përqindja që raportoi vetëcensurë në një masë të moderuar pësoi një rënie (nga 49.2% në 34.5%), ndërsa ata që raportuan në një masë të madhe ose shumë të madhe u rrit paksa në përgjithësi. Të marra së bashku, të dhënat tregojnë se ndonëse intensiteti i vetëcensurës së moderuar mund të ketë ndryshuar, më shumë se gjysma e gazetarëve që përjetuan presion vazhdojnë ta ndryshojnë raportimin e tyre në një farë mase, duke konfirmuar se kërcënimet dhe kanosjet kanë një ndikim të vazhdueshëm në pavarësinë editoriale në vend që të mbeten incidente të izoluar.

Figura 27: Në çfarë mase kërcënimet ose kanosjet ju kanë çuar në praktikimin e vetëcensurës në raportimin tuaj gjatë vitit të kaluar? (Vetëm ata që janë përballur me presion)



3.4.4. Siguria e gazetareve gra

Gazetaret gra në Shqipëri vazhdojnë të përballen me rreziqe specifike për gjininë brenda një mjedisi përgjithësisht të karakterizuar nga presione mbi lirinë e medias dhe pabarazi strukturore. Në vitin 2025, 17.2% e gazetareve gra raportuan se kishin përjetuar kërcënime ose kanosje specifike për gjininë që lidheshin me aktivitetin e tyre profesional. Kjo përqindje ka pësuar një rënie krahasuar me 20.6% në vitin 2024. Gjithsesi, po të kemi parasysh madhësinë e kufizuar të kampionit, ky ndryshim duhet të interpretohet me kujdes.


Figura 28: Përvoja e çdo kërcënimi ose kanosjeje specifike për gjininë në lidhje me punën si gazetare (Vetëm gratë gazetare të anketuara)



Ndër ata që kanë përjetuar kërcënime specifike për gjininë, ngacmimi verbal ishte forma më e zakonshme (80.0%), e ndjekur nga ngacmimi seksual (50.0%) dhe ngacmimi ose abuzimi online (40.0%). Kërcënimet fizike u raportuan nga 10.0% e të anketuarave. Këto gjetje janë tregues se kërcënimet me bazë gjinore janë kryesisht verbale dhe psikologjike për nga natyra, ndonëse një pjesë e konsiderueshme përfshin edhe ngacmimin seksual.


Figura 29: Lloji i kërcënimeve apo kanosjeve me bazë gjinore me të cilat janë përballur gratë (Vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë)

Më shumë se një përgjigje




Është e rëndësishme të theksohet se 60.0% e të anketuarave të kërcënuara raportuan se kanosje të tilla ndikuan në raportimin e tyre të paktën në një masë të moderuar, duke sugjeruar se kërcënimet me bazë gjinore kanë një ndikim të prekshëm në punën e redaksive.

Figura 30: “Në çfarë mase kërcënimet ose kanosjet specifike gjinore kanë ndikuar në raportimin tuaj gjatë vitit të kaluar?” (Vetëm ato që kanë përjetuar diçka të tillë)




Në vitin 2025, 8.6% e gazetareve raportuan se ndiheshin nën presion për të ndryshuar, vonuar ose hequr dorë nga një raportim pikërisht për shkak të gjinisë së tyre, krahasuar me 17.6% në vitin 2024. Edhe pse kjo rënie mund të sugjerojë njëfarë përmirësimi, pothuajse një në njëmbëdhjetë gazetare vazhdon të përballet me presion nga redaksia për shkak të gjinisë. Kjo tregon se kufizimet me bazë gjinore mbeten të pranishme në dinamikën e redaksisë.

Figura 31: “Gjatë vitit të kaluar, a keni ndjerë presion për të modifikuar, vonuar ose hequr dorë nga një histori specifikisht për shkak të gjinisë suaj?”



Lidhur me mbështetjen institucionale, 19.0% e grave gazetare raportuan se shqetësimet e tyre për sigurinë nuk u trajtuan fare nga media për të cilën punonin dhe një përqindje tjetër prej 31.0% raportuan se shqetësimet nuk u trajtuan në mënyrë të mjaftueshme. Edhe pse përqindje të tilla pasqyrojnë njëfarë përmirësimi krahasuar me vitin 2024, kur 29.4% raportuan se shqetësimet nuk u trajtuan fare, një pjesë e konsiderueshme e grave gazetare vazhdojnë të perceptojnë kanë mbrojtje të pamjaftueshme institucionale. Dallimet sipas llojit të mediave sugjerojnë se gratë që punojnë në televizion mund të raportojnë nivele më të ulëta të reagimit institucional sesa ato në mediat online, megjithëse këto gjetje janë thjesht treguese dhe jo statistikisht përfundimtare.

Figura 32: “A keni ndjerë se shqetësimet tuaja për sigurinë si grua gazetare adresohen në mënyrë adekuate nga organizata juaj mediatike?” (Vetëm gratë sipas medias ku punojnë)




Një shumicë e madhe e grave gazetare (87.9%) raportuan se kishin marrë të paktën një masë shtesë sigurie pikërisht për shkak të gjinisë. Përgjigja më e zakonshme ishte forcimi i masave të sigurisë digjitale (41.4%), e ndjekur nga shmangia e detyrave ose vendeve të caktuara (31.0%). Kjo e fundit ka implikime të drejtpërdrejta për mbulimin e lajmeve, pasi mund të kufizojë aftësinë e grave gazetare për të ndjekur histori të caktuara në mënyrë të sigurt. Përqindje më të vogla raportuan se kërkonin mbështetje nga rrjetet e grave gazetare (15.5%) ose përdornin pseudonime ose emra anonimë (13.8%).

Figura 33: Masat e sigurisë për shkak të gjinisë (Vetëm gratë)




Më shumë se një e pesta e grave gazetare (22.4%) raportuan se ato shpesh ose shumë shpesh ndiejnë se të qenit femër ndikon në mënyrën se si trajtohen nga burimet, kolegët ose të intervistuarit. Edhe pse të dhënat krahasuese sugjerojnë ndryshime me kalimin e kohës, vazhdimësia e perceptimeve të tilla tregon se dinamikat gjinore vazhdojnë të formësojnë punën në profesion. Për më tepër, shumica e të anketuarave besojnë se gratë gazetare në Shqipëri përballen me sfida unike krahasuar me homologët e tyre meshkuj, duke përforcuar perceptimin e pengesave strukturore specifike gjinore brenda profesionit.

Figura 34: “Sa shpesh ndjeni që gjinia juaj ndikon në mënyrën se si burimet, kolegët ose të intervistuarit ju trajtojnë?”
(Vetëm gratë, të dhënat e vitit 2025 krahasuar me ato të 2024)



Përafërsisht 82.8% e të anketuarave besojnë se gratë gazetare në Shqipëri përballen me sfida të veçanta në krahasim me burrat. 15.5% e të anketuarave nuk shohin ndonjë ndryshim në sfidat me të cilat përballen gratë në krahasim me burrat.

Figura 35: “A besoni se të qenit grua gazetare në Shqipëri paraqet sfida unike në krahasim me kolegët tuaj burra?”
(Vetëm gratë)




Të dhënat sugjerojnë se, ndonëse disa tregues tregojnë përmirësim të vogël krahasuar me vitin e kaluar, kërcënimet, presionet dhe trajtimi i diferencuar specifik gjinor mbeten të brendësuar në mjedisin profesional. Përhapja e madhe e sjelljes së kujdesshme dhe ndikimi i raportuar në raportim nënvizon se shqetësimet e sigurisë që lidhen me gjininë shtrihen përtej incidenteve të izoluar dhe pasqyrojnë dobësi më të mëdha strukturore.

3.4.5. Denoncimi dhe reagimi


Pavarësisht krijimit të mekanizmave zyrtarë për të adresuar dhunën ndaj gazetarëve, ndërgjegjësimi për këto instrumente mbetet i kufizuar. Në vitin 2025, 68.9% e të anketuarve raportuan se nuk ishin në dijeni të protokollit të posaçëm të sigurisë të miratuar nga Prokuroria, ndërsa 67.0% raportuan të njëjtën mungesë ndërgjegjësimi lidhur me protokollin e Policisë së Shtetit. Gratë gazetare treguan nivel më të ulët ndërgjegjësimi krahasuar me burrat.

Figura 36: “A jeni në dijeni të protokollit të posaçëm për sigurinë e gazetarëve të miratuar nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria?” (Sipas gjinisë)



Ndërgjegjësimi për pikat e caktuara të kontaktit është edhe më i kufizuar: 78.3% e të anketuarve nuk ishin në dijeni të pikës së kontaktit në Prokurori dhe 75.5% nuk ishin në dijeni të pikës së kontaktit në Policinë e Shtetit. Këto gjetje tregojnë një hendek të konsiderueshëm komunikimi në komunikimin e institucioneve me komunitetin e gazetarëve lidhur me garancitë institucionale.

Figura 37: “A jeni në dijeni për pikat e caktuara të kontaktit për sigurinë e gazetarëve në Prokurori dhe Policinë e Shtetit?” (Sipas gjinisë)




Niveli i ulët i ndërgjegjësimit duket se lidhet me numrin e ulët të rasteve të raportuara. Ndër gazetarët që kanë përjetuar kërcënime ose kanosje, vetëm 18.6% raportuan incidente në vitin 2025, një rënie e dukshme nga 39.6% në vitin 2024. Nuk u vunë re dallime të mëdha në nivelin e raportimit për sa i përket gjinisë.

Figura 38: Përqindja e gazetarëve që raportuan kërcënimet ose kanosje te ndonjë autoritet ose institucion (Vetëm ata që u përballën me gjëra të tilla, të dhënat e vitit 2024 krahasuar me ato të 2025)



Arsyeja kryesore e përmendur për mosraportimin ishte mungesa e besimit tek autoritetet (63.9%), e ndjekur nga besimi se raportimi nuk do të sillte ndryshim (27.9%). Edhe pse burrat përmendën më shpesh mungesën e besimit, gratë kishin më shumë gjasa të shprehnin skepticizëm në lidhje me efektivitetin e raportimit, gjë që sugjeron se raportimi i pamjaftueshëm nxitet më pak nga barrierat procedurale dhe më shumë nga joefikasiteti i perceptuar i institucioneve.


Figura 39: Arsyet pse gazetarët nuk i kanë raportuar kërcënimet apo kanosjet tek asnjë autoritet apo institucion (Vetëm ata që kanë përjetuar diçka të tillë, por nuk e kanë raportuar tek asnjë autoritet, sipas gjinisë)



Mes atyre që raportuan incidentet, shumica iu drejtuan policisë (75.0%) dhe Prokurorisë (58.3%), ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme i raportuan rastet edhe te sindikatat e gazetarëve ose mediat ku punojnë (me 41.7% secila).


Figura 40: Autoritetet apo institucionet ku të anketuarit raportuan rastet e kërcënimeve apo kanosjeve (Vetëm ata që raportuan)

Më shumë se një përgjigje




Megjithatë, perceptimet për efektivitetin institucional mbeten të ulëta. Vetëm 16.7% e të anketuarve e konsiderojnë policinë shumë efektive në reagimin ndaj denoncimeve ndërkohë që vetëm 8.3% kanë të njëjtin mendim për Prokurorinë. Si për krahasim, shoqatat e gazetarëve, mediat dhe OJQ-të perceptohen si më të përgjegjshme. Kjo divergjencë përforcon deficitin e besimit të identifikuar më parë dhe është tregues se mekanizmat formalë nuk janë përkthyer ende në mbrojtje të mirëfilltë dhe efikase.

Figura 41: Reagimi nga autoritete të ndryshme siç raportohen nga gazetarët (Vetëm ata që raportuan rastet e tyre)




Ndikimi i kërcënimeve në sjellje ndryshon sipas burimit. Kur kërcënimi buron nga zyrtarët e qeverisë, 25.0% e gazetarëve raportuan se shmangnin tema të caktuara dhe 16.7% raportuan shtim të ankthit ose frikës. Edhe kërcënimet nga grupet politike ose aktorët e bizneseve të fuqishme çuan në ndryshim metodash të raportimit dhe në shtim të ankthit. Në ato raste ku përfshihen reklamues ose pronarë të mediave, 27.3% e të anketuarve raportuan se shmangnin tema të caktuara. Këto problematika tregojnë se burimi i presionit ndikon në krijimin e sjelljes vetëmbrojtëse, por vazhdimisht rezulton në përshtatje të praktikës së raportimit.

Figura 42: Ndikimi kryesor i kërcënimit apo kanosjes nga burimi (Vetëm ata që kanë qenë të kërcënuar apo kanosur)



Kur iu kërkua të identifikonin sfidat kryesore për sigurinë e gazetarëve, 67.9% përmendën presionin dhe ndërhyrjen politike, të ndjekura nga afër nga presioni ekonomik nga pronarët ose reklamuesit e mediave (66.0%) dhe nga mungesa e mbrojtjes ligjore (62.3%). Hendeku i ngushtë mes këtyre faktorëve sugjeron që gazetarët i perceptojnë rreziqet e sigurisë si sistematike dhe shumëplanëshe dhe nuk i atribuohen një kërcënimi të vetëm dominues.

Figura 43: Sfidat kryesore me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri kur bëhet fjalë për sigurinë dhe lirinë nga kërcënimet (Sipas gjinisë)



Më shumë se një përgjigje

Po ashtu, të anketuarit i japin përparësi reformës strukturore: 76.4% identifikojnë mbrojtje më të forta ligjore si masën kryesore për të përmirësuar sigurinë, e ndjekur nga përgjigje më efektive nga ana e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit (60.4%) dhe vullnet më të madh politik për të mbrojtur lirinë e shtypit (59.4%). Zgjidhjet e bazuara në solidaritetet dhe përmirësimet e brendshme të redaksitë renditen më poshtë, duke treguar se gazetarët e shohin sigurinë kryesisht si një çështje qeverisjeje dhe institucionale dhe jo vetëm si një problem i vendit të punës.

Figura 44: Masat apo veprimet kryesore që gazetarët besojnë se mund të ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri



Të dhënat sugjerojnë se, ndonëse ekzistojnë protokollet dhe kanalet formale për raportimin, niveli i kufizuar i ndërgjegjësimit, rënia e numrit të denoncimeve dhe besimi i ulët tek efektiviteti institucional dëmtojnë praktikisht ndikimin e tyre. Hendeku mes mekanizmave formalë dhe mbrojtjes së perceptuar mbetet një sfidë qendrore në forcimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri.

3.4.6. Ecuria drejt dispozitave të Udhërrëfyesit lidhur me sigurinë e gazetarëve

Në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës propozohen masa të rëndësishme për të trajtuar mangësitë në sigurinë e gazetarëve përmes reformave ligjore, ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të koordinimit mes institucioneve të zbatimit të ligjit dhe

prokurorisë.⁶⁸ Në këtë kapitull vlerësohet progresi i bërë në secilën masë bazuar në përgjigjet institucionale dhe të dhënat e mbledhura në sondazhin e vitit 2025.

Masa: Siguria e gazetarëve e garantuar nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të agjencive përkatëse ligjzbatuese. Akademia e Policisë vijon të ofrojë trajnime, duke përfshirë edhe ndjekjen e rasteve të dhunës ndaj gazetarëve që nga viti 2024, bazuar në planifikimin vjetor. Policia e Shtetit dhe shërbimet e prokurorisë përcaktojnë një pikë kontakti brenda strukturave të tyre, përgjegjëse për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve, deri në vitin 2024 dhe sigurojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për raste të tilla, nga viti 2024 e në vazhdim.

Të dhënat tregojnë se është krijuar arkitektura formale institucionale e kërkuar sipas Udhërrëfyesit (udhëzime, pika kontakti, detyra të specializuara dhe komponentë trajnimi). Nga ana procedurale, janë ngritur mekanizma për regjistrimin e rasteve, përcaktimin e përparësive dhe koordinimin, duke demonstruar përparimin dhe përmbushjen e kërkesave për një kohë të gjatë të shoqërisë civile dhe komunitetit të medias.

Më 21 maj 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nxori Urdhrin Nr. 760 ku miratonte “Udhëzimet për Policinë e Shtetit mbi Sigurinë e Gazetarëve dhe Vendosjen e një Pike Kontakti”. Në këto udhëzime përcaktohen procedurat për reagimin e policisë, caktohen pikat e kontaktit në drejtoritë rajonale dhe përshkruhen mekanizmat e koordinimit. Sipas Policisë së Shtetit, pika kontakti janë emëruar në të gjitha drejtoritë vendore të policisë, njësitë e specializuara të krimit kibernetik veprojnë në nivel rajonal dhe të gjithë rastet që kanë të bëjnë me gazetarët regjistrohen në një bazë të dhënash të centralizuar.⁶⁹ Raportohet se janë organizuar aktivitete trajnimi për oficerët e policisë përmes Akademisë së Sigurisë dhe moduli për lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve është përfshirë si pjesë e zhvillimit profesional të forcave të policisë.⁷⁰ Po ashtu, Ministria e Brendshme që nga viti 2024 ka një pikë kontakti të dedikuar për Fushatën e Këshillit të Evropës mbi Sigurinë e Gazetarëve.

⁶⁸ Këshilli i Ministrave. (2023). [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#).

⁶⁹ [SCiDEV, Njoftime për situatën e mediave, maj 2025](#)

⁷⁰ Përgjigja e Policisë së Shtetit ndaj një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025.

Në vitin 2024, Prokurori i Përgjithshëm miratoi një qarkore për hetimin e çështjeve që lidhen me sigurinë e gazetarëve, si një hap të parë drejt krijimit të një mjedisi më të sigurt për gazetarët dhe punonjësit e medias në Shqipëri.⁷¹ Prokuroria e Përgjithshme ka caktuar 13 prokurorë të specializuar për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me gazetarët dhe ka caktuar një pikë të posaçme kontakti.⁷² Nga ana tjetër, janë organizuar aktivitete trajnimi dhe ndërgjegjësimi për punonjësit institucioneve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit.⁷³ Gjatë vitit 2025, vetëm një rast u publikua në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme. Për periudhën janar-shtator 2025, u regjistruan gjithsej katër kallëzime të reja penale, të referuara nga gazetarë që pretendojnë se janë kërcënuar ose dëmtuar për shkak të ushtrimit të detyrave të tyre profesionale. Nga këto raste, tre kallëzime janë aktualisht në fazën e verifikimit paraprak, ndërsa për një kallëzim është regjistruar një procedim penal dhe është në fazën e hetimit.⁷⁴

Partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile kanë mbështetur zbatimin e këtyre masave përmes seminareve dhe takimeve konsultative që synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.⁷⁵ Rritja e bashkëpunimit mes autoriteteve të zbatimit të ligjit, organeve të prokurorisë dhe komunitetit të gazetarëve, veçanërisht përmes dialogut të strukturuar në tryeza e takime të moderuara nga shoqëria civile dhe platforma mediatike, është parë si zhvillim pozitiv. Megjithatë, këto përpjekje kërkojnë institucionalizim dhe konsolidim të mëtijshëm për të garantuar ndikim të qëndrueshëm dhe besim të ndërsjellë.

Megjithatë, evidencat e vënë në dispozicion për vitin 2025 sugjerojnë se ndikimi praktik i këtyre masave ka ende nevojë të konsolidohet. Të dhënat nga sondazhi tregojnë nivel të ulët ndërgjegjësimi mes gazetarëve lidhur me ekzistencën e protokolleve të sigurisë dhe pikave të kontaktit të caktuara për ta. Numri i denoncimeve për kërcënimet dhe kanosjet ra ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar dhe shumica e gazetarëve përmendin mungesën e besimit tek institucionet si një nga arsyt kryesore për mosdenoncimin e shkeljeve. Edhe pse rastet regjistrohen zyrtarisht, të

⁷¹ [Qarkore e Prokurorit të Përgjithshëm 2024](#)

⁷² Përgjigja e Prokurorisë së Përgjithshme ndaj një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025.

⁷³ Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë ndaj një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025.

⁷⁴ Përgjigje ndaj një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025

⁷⁵ [Seminar në Tiranë, Takim konsultativ në Tiranë, Seminar në Fier, Tryezë e rumbullakët në Tiranë, Tryezë e rumbullakët me shumë aktorë në Shkodër, Tryezë e rumbullakët në Korçë](#)

dhënat e bëra publike nuk ofrojnë transparencë të mjaftueshme në lidhje me rezultatet e hetimit, nisjen e procedimit penal nga prokuroria ose efektet parandaluese.

Pavarësisht miratimit zyrtar të masave mbrojtëse, zhvillimet në vitin 2025 ilustrojnë rëndësinë e zbatimit të qëndrueshëm dhe proporcionalitetit në praktikë. Në gusht 2025, disa aksione nga organet ligjzbatuese të Focus Media Group sollën ndërprerjen e transmetimit dhe kufizimin e aksesit të gazetarëve në vendin e tyre të punës dhe në mjediset e prodhimit dhe transmetimit.⁷⁶ Edhe pse çështja kishte të bënte me problematika më të thella ligjore dhe zbatimin urdhrash,⁷⁷ ndikimi i aksionit të policisë mbi gazetarët nxori në pah nevojën për miratimin e protokolleve të qarta kur veprimet nga institucionet shtetërore ndikojnë në punën e mediave. Përfshirja e autoriteteve të zbatimit të ligjit të masat që ndikojnë drejtpërsëdrejti në veprimtarinë e redaksisë thekson më tej rëndësinë e garantimit që kuadri i sigurisë së gazetarëve të zbatohet në mënyrë të njëjtajshme dhe në mënyrë të atillë që përforcon besimin tek institucionet.

Qëndrueshmëria dhe konsolidimi institucional mbeten fusha ku progresi nuk është demonstruar ende plotësisht. Duket se janë organizuar aktivitete trajnimi, por nuk ka informacione të mjaftueshme publike ku të evidentohet nëse aktivitete të tilla janë të përfshira në plane të rregullta vjetore apo nëse ato të jenë vlerësuar për ndikimin që mund të kenë pasur. Ndërgjegjësimi mes gazetarëve lidhur me protokollet ekzistuese të sigurisë dhe pikat e kontaktit të caktuar për ta mbetet i ulët, gjë që sugjeron se mekanizmat e komunikimit dhe informimit nuk kanë arritur ende të depërtojnë te sektori i medias. Për më tepër, asnjë mekanizëm i reagimit të shpejtë për rastet që kanë të bëjnë me sulmet ndaj gazetarëve nuk është funksionalizuar zyrtarisht dhe informimi i publikut lidhur me rezultatet e rasteve mbetet i kufizuar. Këta faktorë tregojnë se edhe pse ekzistojnë struktura procedurale, institucionalizimi dhe efektiviteti i tyre i matshëm kanë mangësi të theksuara.

Masa: Këshilli i Lartë Gjyqësor mbledh dhe nxjerr të dhëna për rastet e përfshirjes së gazetarëve nga viti 2023 e në vazhdim.

Në vitin 2025, është bërë përparim i kufizuar në lidhje me mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për çështjet që kanë të bëjnë me gazetarët. Në përgjigje të një kërkesë për të drejtë informimi,

⁷⁶ Shih [Alarme](#) nga SafeJournalists dhe Këshilli i Evropës, [Alarm](#) nga Platforma e Sigurisë së Gazetarëve

⁷⁷ Shih [këtu](#).

Këshilli i Lartë Gjyqësor konfirmoi se në portalin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës janë të publikuara të dhënat statistikore lidhur me çështjet penale, të filtrueshme për vitet 2024 dhe 2025, përfshirë këtu çështjet sipas Neneve 119 dhe 120 të Kodit Penal. Në të njëjtin portal mund të aksesohen edhe çështjet civile përmes bazës së të dhënave të çështjeve civile.

Megjithatë, funksionaliteti i filtrimit nuk bën të mundur identifikimin sistematik të çështjeve ku përfshihen gazetarë në proceset penale. Për çështjet civile, filtrimi është teknikisht i mundur, por për të përcaktuar nëse një gazetar është paditës apo i padituri dhe nëse çështja lidhet me aktivitetin e tij profesional kërkohet të shqyrtohet manualisht përshkrimi i çështjeve. Sistemi nuk ofron një kategori të posaçme ose një set të dhënash të strukturuar ku të identifikohen posaçërisht gazetarët si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor.

Për më tepër, të dhënat e bëra publike nuk përfshijnë statistika të ndara sipas dënimeve të gazetarëve (përfshirë paditë për shpifje ose rastet me karakteristika të padive SLAPP), numrit të çështjeve të depozituara kundër gazetarëve, por që janë pushuar si çështje, apo bazën ligjore për pushim e tyre. Si rezultat, edhe pse për secilin rast është i publikuar informacioni bazë, mungesa e raportimit të strukturuar dhe të konsoliduar kufizon aftësinë për të vlerësuar tendencat, rezultatet e proceseve gjyqësore apo përdorimin e procedurave ligjore kundër gazetarëve.

Masa: Shkolla e Magjistraturës bën të mundur trajnimin e gjyqtarëve për trajtimin adekuat të padive SLAPP.

Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të një kërkesë për të drejtë informimi, deklaroi se ka pasur progres në kuadër të kësaj mase. Temat mbi lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve janë përfshirë në kurrikulat e Shkollës së Magjistraturës. Në të njëjtën përgjigje, Ministria deklaroi se 38 magjistratë kanë ndjekur seminare dhe trajnime të posaçme mbi mbrojtjen e gazetarëve dhe luftën kundër fushatave të heshtjes së tyre (paditë SLAPP).

Masat: Aspektet penale dhe civile të dispozitave në lidhje me shpifjen harmonizohen plotësisht me standardet e BE-së.

Rregullimi i shpifjes në Shqipëri mbetet një temë e diskutueshme, me zhvillimet në vitin 2025 që pasqyrojnë si përpjekjet për reforma ashtu edhe tensionet e vazhdueshme në lidhje me përafrimin me standardet evropiane.

Në fund të muajit korrik 2025, Ministria e Drejtësisë publikoi Draftin e një Kodi të Ri Penal për konsultim publik. Disa dispozita sipas këtij drafti, të tilla si ato për shpifjen, fyerjen dhe ndikimin në pavarësinë gjyqësore, u konsideruan nga organizatat e lirisë së medias si kërcënime të drejtpërdrejta për lirinë e medias, sigurinë e gazetarëve dhe të drejtën themelore të lirisë së shprehjes.⁷⁸ Organizatat e lirisë së medias shprehën shqetësim se formulime të caktuara mund të zgjerojnë përgjegjësinë penale dhe të rrezikojnë të krijojnë efekte të frikshme në gazetarinë me interes publik dhe në përgjithësi në lirinë e shprehjes.⁷⁹ Alarmet iu dorëzuan Platformës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Gazetarisë, duke theksuar papajtueshmërinë e mundshme me standardet evropiane, duke përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila vazhdimisht thekson se sanksionet penale për shpifjen duhet të përdoren vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Si përgjigje, Ministria e Drejtësisë deklaroi se drafti ishte ende në konsultim dhe se komentet e shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë do të merren në konsideratë për të garantuar harmonizimin dhe përafrimin me standardet evropiane.⁸⁰ Në nëntor 2025, Ministria e Drejtësisë organizoi një takim konsultimi për të diskutuar implikimet e draftit të Kodit Penal mbi lirinë e shprehjes.⁸¹ Megjithatë, deri në fund të vitit, nuk ishte nxjerrë ende asnjë draft i rishikuar ose të ishte komunikuar publikisht një afat kohor për miratimin e tij.

Në dhjetor 2025, Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik organizoi një konsultim të hapur mbi ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, ndryshime që synojnë forcimin e mbrojtjes së gazetarëve dhe punonjësve të medias.⁸² Nisma e prezantuar nga Jorida Tabaku, Kryetare e Komisionit Parlamentar për Çështjet Evropiane, propozon dënime më të rrepta penale për dhunën dhe kërcënimet serioze të kryera ndaj gazetarëve për shkak të aktivitetit të tyre profesional, rritje të mbrojtjes ndaj ndërhyrjeve të paligjshme në aktivitetin e mediave dhe shfuqizimin e dispozitave penale për fyerjen dhe shpifjen, duke i transferuar çështje të tilla tek e drejta civile.⁸³ Kjo nismë bazohet në rezultatet e rekomandimeve të dialogut të strukturuar me

⁷⁸ [Deklaratë e Përbashkët për Draft Kodin Penal dhe pasojat për Lirinë e Medias dhe Lirinë e Shprehjes në Shqipëri](#)

⁷⁹ Shih të gjitha përditësimet për draft Kodin e ri Penal [këtu](#).

⁸⁰ Shih [përgjigjen](#) e Ministrisë së Drejtësisë për Platformën e Këshilli i Evropës për Sigurinë e Gazetarëve.

⁸¹ SCiDEV. (nëntor 2025). [Përmbledhje për situatën e mediave](#).

⁸² SCiDEV. (nëntor 2025). [Përmbledhje për situatën e mediave](#).

⁸³ Shih more [këtu](#).

median lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe i përgjigjet masave të parashikuara në Udhërrëfyes. Deri në fund të vitit 2025, drafti ishte ende në shqyrtim në Kuvend.⁸⁴ Përmbushja e qëllimit të kësaj nisme dhe përafrimi me standardet evropiane do të varen nga rezultati i procesit legjislativ dhe përfshirja e sugjerimeve të shoqërisë civile, mediave dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Së fundmi, në dhjetor 2025, Kryeministri propozoi publikisht dekriminalizimin e shpifjes ekskluzivisht për gazetarët, duke e paraqitur këtë si një masë për të mbrojtur lirinë e medias.⁸⁵ Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile konsiderojnë se standardet evropiane dhe ndërkombëtare mbështesin dekriminalizimin e përgjithshëm për të gjithë pjesëmarrësit në debatin publik, jo përjashtime specifike sipas profesionit. Regjimi i diferencuar i propozuar krijon pasiguri ligjore dhe trajtim të pabarabartë, duke përjashtuar qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe mbikëqyrësit e interesit publik nga mbrojtja kundër efektit frenues të sanksioneve penale.⁸⁶

Të marra së bashku, zhvillimet e vitit 2025 pasqyrojnë pista paralele dhe pjesërisht të duplikuara të reformave. Edhe pse disa nisma, veçanërisht propozimi për shfuqizimin e dispozitave penale për fyerjen dhe rritja e mbrojtjes, tregojnë lëvizje drejt përafrimit me standardet evropiane, qarkullimi njëkohësisht i projekt-dispozitave që potencialisht zgjerojnë përgjegjësinë penale dhe propozimi i dekriminalizimit të shpifjes vetëm sipas profesionit sjellin rreziqe të fragmentarizimit të politikave dhe pasiguri ligjore. Nismat divergjente legjislative që dalin nga aktorë të ndryshëm institucionalë mund të dëmtojnë koherencën dhe qëndrueshmërinë, veçanërisht nëse nuk harmonizohen në kuadër të një qasjeje të unifikuar të bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe standardet e BE-së. Si rezultat, progresi drejt harmonizimit të plotë të dispozitave penale dhe civile për shpifjen me parimet evropiane mbetet i paplotë dhe me hope, me përparime në fusha të caktuara të kundërbalancuara nga paqartësi të pazgjidhura dhe mospërputhje strukturore.

⁸⁴ Ky propozim u refuzua nga shumica dhe në janar 2026 u paraqit dhe u miratua në Parlament një draft i ri që nuk ishte konsultuar më parë, duke dekriminalizuar pjesërisht shpifjen vetëm për kategori të caktuara gazetarësh. Kjo u kundërshtua nga shoqëria civile dhe organizatat e lirisë së medias. Shih më shumë rreth këtij zhvillimi në [Përmbledhjen e Situatës së Mediave të SCiDEV](#) të janarit 2026. Meqenëse ky zhvillim bie jashtë periudhës së raportimit, ai do të analizohet në raportin pasues.

⁸⁵ IDP. (16 dhjetor 2025). [Konferenca e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit](#).

⁸⁶ [Përmbledhje për situatën e mediave, dhjetor 2025](#)

Masa: Publikimet mashtruese ose të pasakta të përafruara me standardet dhe rekomandimet evropiane. Analizë e plotë të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP-e), përfshirë masa korigjuese nëse është e nevojshme, qoftë në ligj apo praktikë institucionale, në përputhje me standardet evropiane dhe acquis.

Ministria e Drejtësisë ka filluar punën përgatitore për përafrimin e Direktivës (BE) 2024/1069, përfshirë këtu edhe përgatitjen e një table përrputshmërie dhe një analizë të mangësive ligjore për të identifikuar dispozitat në legjislacionin vendas që kanë nevojë për ndryshime. Në tetor të vitit 2025, Ministria raportoi se janë planifikuar ndryshime në Kodin e Procedurës Civile dhe në Ligjin Nr. 11/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, me synim përafrimin e legjislacionit kombëtar me Direktivën deri në vitin 2026.⁸⁷ Këta hapa tregojnë se procesi i përafrimit ka nisur zyrtarisht. Gjithsesi, deri në fund të vitit 2025, projekt-ndryshimet nuk ishin publikuar ende për konsultim publik dhe nuk ishte shpallur asnjë afat kohor i detajuar për zbatimin e tyre. Prandaj, efektiviteti i përafrimit do të varet nga shtrirja, qartësia dhe kohëzgjatja e propozimeve të ardhshme legjislative.

3.5. Kushtet e punës së gazetarëve

Gazetarët në Shqipëri punojnë në një mjedis socio-ekonomik të pasigurt nga ana strukturore që ndikon drejtpërsëdrejti në aftësinë e tyre për të bërë gazetari me interes publik. Pasiguria për vendin e punës, pagat e ulëta dhe të parregullta, informaliteti dhe zbatimi i dobët i të drejtave të punës mbeten të përhapura në të gjithë sektorin e medias.⁸⁸ Inspektimet nga Inspektorati i Punës kanë konfirmuar shkelje në të gjithë sistemin, me problematika të ndryshme si paga të papaguara, mungesë kontratash, punë e padeklaruar dhe shkarkime të paligjshme nga puna.⁸⁹ Sindikalizmi mbetet i dobët, mungojnë mekanizmat e negociatave kolektive dhe gazetarët kanë ndikim të kufizuar te pronarët e medias.⁹⁰ Ky çekuilibër rrit ndjeshëm ekspozimin ndaj presionit politik dhe ekonomik.

⁸⁷ Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë ndaj një kërkesë për të drejtë informimi, tetor 2025


⁸⁸ Karaj, V. & Mitre, O. (2025). [Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2024-2025](#). Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

⁸⁹ [Shqipëri: Përmirësimi i Kushteve të Punës për Gazetarët – Inspektorati i Punës dhe AMA Organizon Tryezë Diskutimi me Median](#)

⁹⁰ Bino, B. (2025). [SHQIPËRIA: Treguesit për Nivelin e Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2024](#). Rrjeti SafeJournalists.

Shumica e gazetarëve të anketuar për këtë raport, 41.5%, nuk perceptojnë asnjë ndryshim në kushtet e punës krahasuar me vitin e kaluar. 36.8% e tyre perceptojnë një përkeqësim të kushteve të punës krahasuar me vitet e kaluara dhe 21.1% perceptojnë përmirësim. Nga pikëpamja gjinore, perceptimet mbi përkeqësimin e kushteve të punës janë pothuajse të ngjashme mes burrave dhe grave, duke arritur përkatësisht në 37.6% dhe 36.2%. Megjithatë, më shumë gazetarë burra, 25.0% e tyre, perceptojnë përmirësim në kushtet e punës, krahasuar me vetëm 18.9% të grave. Redaktorët janë kategoria që perceptoi më shumë një përkeqësim të kushteve të punës krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 41.1%, të ndjekur nga reporterët, 37.3%, dhe gazetarët e tjerë me 31.8%. po ashtu, redaktorët përbëjnë shumicën e të anketuarve në perceptimin e një përmirësimi të kushteve të punës krahasuar me vitin e kaluar.

Figura 45: Përmirësimi i kushteve të punës krahasuar me vitin e kaluar (Sipas rolit)



Në qershor 2025, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe sindikatave të gazetarëve⁹¹ u takuan me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, duke diskutuar rëndësinë e sindikalizimit, edukimin e gazetarëve mbi rolin dhe kompetencat e Inspektoratit si dhe nxitjen e dialogut të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të informacionit mes palëve. Për të adresuar kushtet e punës së gazetarëve, në maj 2025 AMA dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale nënshkruan një memorandum mirëkuptimi. Nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë pritet të forcohet zbatueshmëria e të drejtave të punës dhe të përmirësohen kushtet e punës në sektor.⁹²

Përpjekjet për të marrë të dhëna të kategorizuara sipas gazetarëve të regjistruar si taksapagues nga Administrata Tatimore rezultuan të pasuksesshme. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u përgjigj se nomenklatura e saj e aktiviteteve ekonomike (NVE Rev 2) nuk përfshin një përcaktim specifik për gazetarët ose punonjësit e medias dhe për këtë arsye nuk mund të gjenerojë statistika në formatin e kërkuar.

Për të trajtuar kushtet e punës mes punonjësve të medias në Shqipëri, në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës u përfshinë dy masa.

Masa: Inspektorati Shtetëror i Punës miraton një metodologji inspektimi bazuar në rrezik për zbatimin e të drejtave në punë të gazetarëve deri në vitin 2025. ASPA vijon të ofrojë trajnime për stafin e Inspektoratit Shtetëror të Punës për kryerjen e inspektimeve të bazuara në rrezik për të drejtat në punë të gazetarëve.

Në vitin 2025, të dhënat tregojnë se Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale zbatoi një qasje të bazuar në risk ndaj inspektimeve të punës si pjesë e metodologjisë së tij të përgjithshme. Inspektorati administron një sistem elektronik planifikimi për inspektimet ku përfshin mjete të vlerësimit të riskut, si Sistemi i Analizës së Riskut (RAS), dhe mekanizma për përcaktimin e përparësisë të bazuar në të dhëna. Gazetaria dhe mediat audiovizive janë identifikuar si sektorë me risk më të lartë dhe gjatë viteve 2024–2025 janë kryer inspektime në subjekte mediatike, duke vendosur edhe masa ndëshkimore në përgjigje të shkeljeve të raportuara në punë. Në maj 2025, AMA nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Inspektoratin Shtetëror

⁹¹ [SCIDEV Përmbledhje për situatën e mediave, qershor 2025](#)

⁹² [AMA marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës.](#)

të Punës për të forcuar bashkëpunimin në monitorimin e kushteve të punës në sektorin e mediave audiovizive, për respektimin e Kodit të Punës dhe mbrojtjes sociale. Hapa të tillë janë tregues se institucionet i njohin dobësitë e punës në sektorin e medias dhe rëndësinë e zbatimit në praktikë të mjeteve të inspektimit të bazuara në risk. Të dhënat e sondazhit që tregojnë shqetësime të vazhdueshme lidhur me kontratat dhe kushtet e pasigurta të punës sugjerojnë më tej se legjislacioni nuk zbatohet njësoj nga mediat.

4. UDHËRRËFYESI PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

Në tetor 2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Udhërrëfyesin për Funkzionimin e Institucioneve Demokratike, ku përfshihen disa angazhime që lidhen me median në kontekstin e zgjedhjeve.⁹³ Këto masa parashikojnë ndryshime legjislative në Kodin Zgjedhor përmes konsensusit të gjerë ndërpartiak deri në vitin 2026 dhe, brenda të njëjtit afat kohor, ndryshime ligjore për forcimin e efikasitetit dhe pavarësisë së rregullatorit të mediave audiovizive në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Udhërrëfyesi parashikon edhe miratimin e një kuadri rregullator për organet që monitorojnë median online gjatë zgjedhjeve duke filluar nga viti 2026. Është e rëndësishme të theksohet se dy masa ishin planifikuar të fillonin me zgjedhjet e vitit 2025: rritja e monitorimit sasior dhe cilësor dhe profesionalizmit në raportimin e mediave gjatë fushatave, si ngritja e kapaciteteve për AMA-n përmes projektit “Modernizimi i studios së monitorimit”; dhe investimi në kapacitete për të adresuar dezinformimin gjatë proceseve zgjedhore, përfshirë këtu edhe grupet përkatëse të synuara.

Po ashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pritet të vazhdojë zbatimin e mekanizmave të konsoliduar të monitorimi, si kontrolli i fushatave digjitale dhe bashkëpunimi me platformat e rrjeteve sociale për të luftuar dezinformimin dhe manipulimin. Këto angazhime i konsiderojnë zgjedhjet e vitit 2025 si një provë e parë e mekanizmave të përmirësuar të mbikëqyrjes së medias dhe përgjigjes ndaj dezinformimit sipas Udhërrëfyesit.


Analiza e mëposhtme mbështetet te të dhënat e sondazhit që shtjellon perceptimet e gazetarëve për mbulimin e zgjedhjeve në vitin 2025, duke ofruar një vlerësim të bazuar në evidencë nëse angazhimet e Udhërrëfyesit për monitorimin e medias, profesionalizmin dhe luftën kundër dezinformimit u përkthyen në ndryshime të qarta në praktikë.

⁹³ Ministria e Drejtësisë. (2 tetor 2024). [Vendimi Nr. 611, datë 2 tetor 2024, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funkzionimin e Institucioneve Demokratike”](#). Ministria e Drejtësisë.

4.1. Mbulimi i zgjedhjeve: akses, presioni dhe ndikimi në redaksi


Një shumicë mjaft e konsiderueshme e të anketuarve (afërsisht 83%) raportuan se kishin mbuluar fushatën zgjedhore të 11 majit 2025. Ndër ata që mbuluan zgjedhjet, 29.5% raportuan se kishin hasur vështirësi të shpeshta në marrjen e informacionit, ndërsa 40.9% raportuan vështirësi të rastit. Në total, afërsisht 70% e gazetarëve që mbuluan fushatën hasën njëfarë kufizimi në akses, duke treguar se marrja e informacionit gjatë periudhës zgjedhore ishte vështirësi më vete.

Figura 46: “A hasët vështirësi në aksesin në informacion gjatë raportimit të fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve të 11 majit 2025?”




Të ndarë sipas gjinisë, burrat raportuan më shumë vështirësi në marrjen e informacionit krahasuar me gratë.

Figura 47: “A hasët vështirësi në aksesin në informacion gjatë raportimit të fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve të 11 majit 2025?” (Sipas gjinisë, vetëm ata që mbuluan fushatën zgjedhore)



Përveç pengesave në marrjen e informacionit, 23.9% e gazetarëve që mbuluan zgjedhjet raportuan se ishin përballur me presione ose kërcënime në lidhje me punën e tyre. Burrat kishin më shumë gjasa në krahasim me gratë të raportonin incidente të tilla.


Figura 48: “Gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, a jeni përballur me ndonjë formë presioni ose kërcënim në lidhje me punën tuaj si gazetar/e?” (Sipas gjinisë)



Më shumë se gjysma e të anketuarve që mbuluan procesin zgjedhor identifikuan kandidatët politikë (52.4%) dhe anëtarët e partive politike (52.4%) si burimin kryesor të kërcënimeve ose kanosjeve. Përveç kësaj, 38.1% përmendën zyrtarët qeveritarë si burimin kryesor të presionit.


Kjo u pasua nga pronarët ose drejtuesit e mediave ku punojnë, organizatat kriminale dhe bizneset ose grupet e interesit—secila e përmendur nga 14.3% e të anketuarve si burimi kryesor i kërcënimit ose kanosjes.

Figura 49: Burimi kryesor i kërcënimit ose kanosjes sipas burimit (Vetëm ata që kanë qenë të kërcënuar ose të kanosur gjatë fushatës zgjedhore)




E përhapur ishte edhe armiqësia online. Plot 17% e të anketuarve raportuan sulme të shpeshta online, ndërsa 28.4% i përjetuan ato herë pas here. Burrat raportuan më shumë raste në krahasim me gratë.

Figura 50: "A keni qenë subjekt i sulmeve online (p.sh. komente ofenduese, kërcënime, diskreditime) gjatë mbulimit të zgjedhjeve?" (Sipas gjinisë)




Rreth 60% e të anketuarve nuk i raportuan rastet e presionit, kërcënimeve ose sulmeve tek autoritetet përkatëse gjatë mbulimit të zgjedhjeve. Një përqindje më e lartë e grave të anketuara zgjodhën të mos i raportonin raste të tilla krahasuar me të anketuarit burra. Vetëm 8.0% e të gjithë të anketuarve deklaruan se i kishin raportuar këto incidente.

Figura 51: “Nëse jeni përballur me presione, kërcënime apo sulme gjatë mbulimit të zgjedhjeve, a keni raportuar këto incidente tek institucionet kompetente?” (Sipas gjinisë)




Periudha zgjedhore e përkeqësoi lirinë për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe pa frikë nga censura për 27.8% të të anketuarve. Më konkretisht, 14.5% deklaruan se situata ishte përkeqësuar ndjeshëm, ndërsa 13.3% raportuan një përkeqësim të lehtë. Të anketuarit burra kishin më shumë gjasa të besonin se periudha zgjedhore ndikoi negativisht në lirinë e tyre të raportimit në krahasim me gratë gazetare.

Figura 52 “Sipas jush, si ndikoi periudha zgjedhore në lirinë tuaj për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe pa frikë nga censura?”




Pothuajse dy të tretat e të anketuarve deklaruan se gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve atyre u janë ofruar materiale të përgatitura paraprakisht, gjë që rezultoi në shmangien e pyetjeve ose intervistave të drejtpërdrejta. Konkretisht, 47.7% raportuan se kjo ndodhte shpesh, ndërsa 18.2% thanë se kjo ndodhte ndonjëherë.

Figura 53: “Gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, a ju është ofruar nga partitë apo kandidatët material mediatik i parapërgatitur (video, audio apo tekst), duke shmangur pyetjet direkte apo intervistat?” (Sipas gjinisë)




Pothuajse gjysma e të anketuarve (48.9%), me një përqindje më të lartë burra sesa gra, raportuan se materialet e përgatitura paraprakisht kanë kufizuar punën e tyre si gazetarë dhe pavarësinë editoriale.

Figura 54: “Nëse ju janë ofruar materiale të gatshme nga partitë apo kandidatët, a e keni ndjerë këtë praktikë si një mënyrë për të kufizuar punën tuaj si gazetar/e dhe pavarësinë editoriale?” (Sipas gjinisë)



Pothuajse gjysma e të anketuarve (46.6%) raportuan se ndiheshin nën presion nga partitë politike ose kandidatët për të përdorur vetëm materialet e ofruara, duke kufizuar kështu aftësinë e tyre për të kryer intervista të pavarura. Ky presion u raportua më shpesh nga gazetarët burra sesa nga gratë, nga redaktorët më shumë sesa nga reporterët dhe nga ata që punonin në televizion krahasuar me ata në mediat online.

Figura 55: “A jeni ndjerë të detyruar nga partitë apo kandidatët për të përdorur vetëm materialet e ofruara prej tyre, duke ju kufizuar mundësinë për intervista apo raportim të pavarur?”




Tre në katër të anketuar (75.6%) deklaruan se përdorimi i materialeve mediatike të përgatitura paraprakisht çoi në një rënie të cilësisë së raportimit. Përveç kësaj, 61.0% besonin se kjo kufizonte aftësinë e tyre për të bërë pyetje kritike, 53.7% vunë në dukje krijimin e perceptimeve mashtruese në publik dhe 51.2% raportuan një ndikim negativ në pavarësinë editoriale.

Figura 56: “Si ndikoi praktika e materialeve të parapërgatitura në cilësinë dhe pavarësinë e raportimit tuaj gjatë zgjedhjeve?”




Një e treta e të anketuarve (39.8%) raportoi se qasja e tyre në aktivitetet zgjedhore, aktivitetet e fushatës ose deklaratat publike shpesh kufizohej nga partitë ose kandidatët gjatë periudhës zgjedhore, ndërsa një 19.3% shtesë raportuan kufizime sipas rastit. Kufizime të tilla u përjetuan më shumë nga burrat sesa gratë.

Figura 57: “A u kufizua aksesu juaj në evente zgjedhore, aktivitete të fushatës, apo deklarata publike të partive/kandidatëve gjatë periudhës zgjedhore (11 maj 2025)?” (Sipas gjinisë)



Rreth 70% e të anketuarve që përjetuan kufizime aksesit raportuan përjashtim të qëllimshëm nga aktivitetet zgjedhore, 61.5% u përballën me pengim fizik për të marrë pjesë në aktivitete publike, 44.2% hasën kufizime për të bërë pyetje dhe intervista të drejtpërdrejta, 15.4% përjetuan përdorimin e kushteve selektive për dhënien e aksesit dhe 9.6% raportuan pezullim ose kufizim të akreditimit.

Figura 58: “Në çfarë mënyre u realizua ky kufizim i aksesit tuaj si gazetar/e?”



Të marra së bashku, të dhënat sugjerojnë se periudha zgjedhore e vitit 2025 u karakterizua nga kufizime të shumta në marrjen e informacionit, nga presioni politik, armiqësitë digjitale dhe praktika të strukturuar të kontrollit të informacionit. Ndonëse jo universale, këto forma tregojnë se kontekstet zgjedhore vazhdojnë të paraqesin sfida sistematike për gazetarinë e pavarur, me implikime për transparencën, pluralizmin dhe llogaridhënien demokratike.

4.2. Ecuria në Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike

Masa 1: Rritja e monitorimit sasior dhe cilësor dhe profesionalizmit në raportimin e mediave gjatë fushatave, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të AMA-s përmes projektit “Modernizimi i studios së monitorimit”.

Raporti i ODIHR-it⁹⁴ konstatoi se AMA i dërgoi KQZ-së raporte monitorimi ditore dhe javore, në përputhje me ligjin, duke mbuluar aspektin sasior të kërkesës së përcaktuar në masë. Ndonëse raporti thekson se monitorimi nuk vlerësoi cilësinë e mbulimit, duke mos trajtuar kështu aspektet cilësore të masës. Për më tepër, raporti thotë se KQZ-ja e mori raportin e monitorimit që mbulon periudhën 1-10 maj vetëm më 19 maj, një javë pas zgjedhjeve.

Të dhënat, si nga raporti i ODIHR-it, ashtu edhe nga monitorimi i pavarur dhe sondazhi i zhvilluar me profesionistë të medias, tregojnë dominimin e materialeve të parapërgatitura të dërguara në media gjatë fushatës zgjedhore. Monitorimi i mediave audiovizive dhe ato online nga BIRN Albania gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ofron një pasqyrë shtesë cilësore dhe strukturore mbi format e mbulimit të fushatës. Nga monitorimi i mediave online identifikohet ripublikimi në masë nëpër portale të materialeve të njëjta të fushatës, me diversitet të ulët të burimeve dhe tituj që shpesh amplifikonin mesazhet politike pa verifikimet e rastit.⁹⁵

Monitorimi audioviziv i edicioneve të lajmeve në orarin me shikueshmëri më të lartë dhe i emisioneve politike në të gjithë transmetuesit kombëtarë tregoi një varësi të konsiderueshme të materialet e parapërgatitura për fushatën dhe raportimin e ngjarjeve, me shumë pak hapësirë për të bërë pyetje ose debat kritik.⁹⁶ Dallimet midis transmetuesve publikë dhe privatë ishin të dukshme në aspektin e ndarjes së kohës së transmetimit dhe formatit, por në të gjitha mediat mbizotërimi i përmbajtjes së prodhuar nga partitë uli mundësitë për shqyrtim në thelb të fushatës. Këto gjetje sugjerojnë se, ndonëse u përmbushën kërkesat formale të monitorimit sasior, dimensionin cilësor të mbulimit të

⁹⁴ Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (23 tetor 2025). [Shqipëria, zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025: Raporti përfundimtar](#). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.).

⁹⁵ Voko, K., Babameto, S. & Keta, V. (2025). [Monitorimi i Mediave Online Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë 2025](#). BIRN Albania. Tirana.

⁹⁶ Voko, K., Lelo, E., & Shehu, J. (2025). [Monitorimi i Mediave Audiovizive/ Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë 2025](#). BIRN Albania.

zgjedhjeve, veçanërisht pavarësia editoriale, përfaqësimi pluralist dhe angazhimi për të bërë pyetje e debate kritike, mbetën të kufizuara nga pikëpamja strukturore gjatë periudhës së fushatës.

Më 9 nëntor, në pesë bashki të Shqipërisë, Vlorë, Berat, Mat, Tepelenë dhe Cërrik, u zhvilluan zgjedhje të pjesshme. Fushata zgjedhore zgjati shtatë ditë dhe, duke ndjekur praktikën e zgjedhjeve të përgjithshme të 11 majit, AMA i dërgoi KQZ-së raportet sasiore të monitorimit të medias, me kohën e transmetimit të ndarë për kandidatët për kryetarë bashkie. Informacioni mbetet mjaft i kufizuar për çdo monitorim të mëtejshëm cilësor të hapësirës informative gjatë këtyre zgjedhjeve.

Masa 2: Investime në kapacitete me fokus në dezinformimin gjatë proceseve zgjedhore, ku të përfshihet grupet përkatëse të synuara.

Në korrik 2025, parlamenti shqiptar miratoi Ligjin për “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030”.⁹⁷ Strategjia parashikon përafrimin e ngushtë me acquis të BE-së lidhur me shërbimet digjitale, lirinë e medias dhe inteligjencën artificiale. Ajo thekson forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, mediave të pavarura, gazetarisë investigative, verifikimin e fakteve dhe promovimin e edukimit të publikut për të luftuar në mënyrë efektive rreziqet që vijnë nga dezinformimi. Zbatimi i strategjisë mbetet sfida më e madhe, gjë që bën të nevojshme marrjen e masave të qarta mbrojtëse për të parandaluar keqpërdorimin e mundshëm të strategjisë për etiketim të kritikave legjitime ose mendimit ndryshe si dezinformim ose ndërhyrje e huaj.⁹⁸

Sipas objektivit të parë të strategjisë “Ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore”, parashikohet krijimi i një njësie të posaçme për monitorimin dhe reagimin e menjëhershëm ndaj dezinformimit dhe manipulimit të informacionit. Strategjia parashikoi që kjo masë të zbatohet brenda 12 muajve dhe institucionet përgjegjëse ishin komisioni parlamentar përgjegjës, KQZ-ja dhe Ministria e Drejtësisë.

⁹⁷ [Fletorja Zyrtare nr. 138, 2025](#)

⁹⁸ [SCiDEV Përmbledhje për situatën e mediave qershor 2025](#)

ODIHR⁹⁹ deklaroi se para zgjedhjeve, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) organizoi një trajnim për KQZ-në lidhur me metodat e monitorimit të gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe shpenzimeve në rrjetet sociale. Përveç kësaj, raporti evidenton ngritjen nga KQZ-ja të një njësie të posaçme për të monitoruar profilet në rrjetet sociale të 150 institucioneve publike gjatë fushatës dhe trajnimin që mori për zbulimin e dezinformimit në lidhje me zgjedhjet.

Në mars të vitit 2025, para zgjedhjeve parlamentare, shtatë parti politike, përfshirë dy partitë kryesore, nënshkruan një kod sjelljeje për fushatat digjitale.¹⁰⁰ Kodi, i mundësuar nga partnerët ndërkombëtarë me pjesëmarrjen e KQZ-së, nuk është detyrues, por synon të krijojë një angazhim të përbashkët ndaj integritetit, transparencës, privatësisë, sigurisë, drejtësisë dhe një fushë të barabartë loje, përfshirë këtu refuzimin për prodhimin apo shpërndarja e përmbajtjes së rreme.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, të dhënat nga monitorimi tregojnë se periudha zgjedhore u shënjua nga një rritje e konsiderueshme e dezinformimit online dhe përmbajtjes manipuluese, ku përfshihen si zyrtarë politikë ashtu edhe faqe të aktorëve të tretë pa lidhje me ta.¹⁰¹ Edhe pse imazhet e gjeneruara nga intelijenca artificiale dhe përmbajtja e modifikuar me instrumente artificiale ishin të dukshme gjatë fushatës,¹⁰² ato përfaqësonin vetëm një komponent të një ekosistemi më të gjerë që karakterizohej nga narrativa mashtruese, pretendime të ricikluara të paverifikuara, amplifikim të koordinuar përmes faqeve jozyrtare dhe mesazhe politike të nxitura nga angazhimi, të cilave u mungonte transparenca.

Raporti i Monitorimit të Rrjeteve Sociale i International IDEA mbi zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë 2025 identifikoi 58 faqe dhe llogari të palëve të treta në rrjetet sociale që u shfaqën gjatë periudhës së fushatës.¹⁰³ Këto faqe nuk ishin subjekte zyrtare politike ose media të verifikuara,

⁹⁹ Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (23 tetor 2025). [Shqipëria, zgjedhjet parlamentare, 11 maj 2025: Raporti përfundimtar](#). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.)

¹⁰⁰ Gjonçaj, M., & Shehu, J. (2025). [Partitë shqiptare miratojnë kodin e sjelljes për fushatat digjitale](#). International IDEA.

¹⁰¹ Likmeta, B. (31 janar 2025). [Kukull me çorape: Faqja anonime në Instagram shpërndan dezinformimin për Lëvizjen Bashkë](#). Reporter.al.

Karaj, V. (4 prill 2025). [Profilet anonime targetojnë edhe drejtuesit e "Nisma Shqipëria Bëhet"](#). Reporter.al.

Karaj, V. (1 prill 2025). [Profili anonim në Facebook shpërndan dezinformim kundër partisë "Mundësia"](#). Reporter.al.

¹⁰² Karaj, V. (10 maj 2025). [Profilet në Facebook nga Vietnamitë përmbajtjet e Ramës në Opinion](#). Reporter.al.

¹⁰³ Likmeta, B., & Voko, K. (2025). [Monitorimi i rrjeteve sociale: Zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë 2025](#). International IDEA.

ndonëse shpërndanë vazhdimisht përmbajtje me mesazh të qartë politik, përfshirë edhe materiale mashtruese dhe të manipuluar. Rritja tejet e madhe e aktorëve të tillë ilustron cenueshmërinë strukturore të mjedisit të informacionit online, ku veprimet për rritjen e ndikimit mund të kryhen përmes rrjeteve digjitale me lidhje të hapura apo të fshehta dhe jo përmes kanaleve të fushatës zyrtarisht të përgjegjshme.

Nga ana tjetër, zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit 2025 u karakterizuan nga dezinformimi me bazë gjinore,¹⁰⁴ veçanërisht dezinformimi i krijuar nga inteligjenca artificiale dhe sulmet digjitale që synonin pikërisht gratë.¹⁰⁵ Objekt i dezinformimit online, i shoqëruar me gjuhë urrejtjeje, ishin kandidatet gra që i përkisnin partive të ndryshme politike, politikane me përvojë dhe të reja.¹⁰⁶

Këto zhvillime konfirmojnë gjetjet e Vlerësimit të Vulnerabilitetit të vitit 2025 lidhur me Manipulimin e Informacionit dhe Ndërhyrjen e Huaj (FIMI), ku arrihet në përfundimin se mjedisi zgjedhor në Shqipëri mbetet i ekspozuar nga ana strukturore ndaj rreziqeve të dezinformimit dhe ndikimit të jashtëm. Në vlerësim identifikohen një sërë faktorësh që e bëjnë të mundur, si besimi i ulët tek institucionet, tregu mediatik i përqendruar dhe i orientuar politikisht, boshllëqet në sistemin rregullator për sa i përket sferës digjitale, reklamën e fshehtë politike online dhe kapaciteti i profileve të palëve të treta për të amplifikuar shpejt përmbajtje, faktorë që krijojnë terren pjellor për narrativa manipuluese gjatë periudhave zgjedhore.

Është e rëndësishme të theksohet se studimi evidenton rreziqet dezinformimit dhe manipulimit të informacionit në Shqipëri që nuk varen domosdoshmërisht nga përafrimi i ideologjive në vend me aktorët e huaj. Përkundrazi, ato veprojnë përmes formave hibride dhe oportuniste, duke shfrytëzuar polarizimin ekzistues, dobësitë e qeverisjes dhe logjikën e nxitur nga shpejtësia e ekosistemeve të mediave online. Në këtë kontekst, edhe pse miratimi i Strategjisë Kombëtare përfaqëson një hap të rëndësishëm politik, zgjedhjet e vitit 2025 tregojnë se përgatitja institucionale, koordinimi ndërinstitutional dhe mekanizmat e zbatimit rregullator mbeten të pamjaftueshme për të parandaluar në zgjedhjet e ardhshme përsëritjen e fushatave të koordinuara të dezinformimit ose operacioneve të manipulimit të informacionit nga të huajt.

¹⁰⁴ Karaj, V. (6 qershor 2025). [Pas perdes së fushatës: Gratë candidate u sulmuan me gjuhë seksiste dhe denigruese](#). Reporter.al.

¹⁰⁵ UN Women Shqipëri, Rrjeti Barazi në Vendimarrje dhe BIRN Albania. (2025). [Gratë në politikë 2025 – Fleta informative dhe gjetjet e monitorimit të medias](#).

¹⁰⁶ [Gjetjet mbi Dhunën me Bazë Gjinore në Media dhe Rrjetet Sociale gjatë Fushatës Zgjedhore të vitit 2025](#)

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1. Përfundime

Në vitin 2025, Shqipëria demonstroi një përafrim të matshëm procedural me standardet e BE-së në disa fusha që lidhen me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Kornizat institucionale janë miratuar ose forcuar, duke përfshirë udhëzime për sigurinë e gazetarëve, regjistra për transparencën e pronësisë, platforma dialogu të strukturuar dhe punë përgatitore për përafrimin me EMFA dhe DSA, si dhe hapa përgatitorë drejt reformës kundër SLAPP dhe shpifjes. Megjithatë, dëshmitë në të gjithë këtë raport tregojnë se efektiviteti operacional dhe ndikimi i matshëm mbeten në nivele mjaft të ndryshme. Ekziston një model i përsëritur sipas së cilit ekzistojnë mekanizma formalë, por ndërgjegjësimi, zbatimi, transparenca e rezultateve dhe besimi tek institucionet mbeten të kufizuara.

Dobësitë strukturore vazhdojnë të ndikojnë dukshëm në sektorin e medias. Aktorët politikë mbeten burimi kryesor i kërcënimeve dhe presionit të raportuar nga gazetarët. Përqendrimi i pronësisë së mediave vazhdon të ekzistojë, pa masa të detyrueshme për garantimin e pluralizmit strukturor. Pasiguria në punë dhe varësia ekonomike rrisin cenueshmërinë ndaj ndikimit.. Kërcënimet me bazë gjinore dhe ngacmimi online mbeten tipare të ngulitura në sektorin e medias. Këto sfida nuk janë episodike, por sistemike.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 funksionuan si një test praktik i angazhimeve të institucioneve. Të dhënat nga sondazhi dhe monitorimi i pavarur tregojnë se kufizimet e në marrjen e informacionit, presioni politik, kontrolli i strukturuar i mesazheve përmes materialeve të parapërgatitura dhe tendencat e dezinformimit ndikuan në mjedisin e fushatës. Ndërsa mekanizmat sasiorë të monitorimit funksionuan normalisht, vlerësimi cilësor dhe reagimi në kohë reale ishin të kufizuara. Periudhat zgjedhore vazhdojnë të amplifikojnë presionet strukturore ekzistuese mbi gazetarinë e pavarur.

Besimi tek institucionet mbetet i brishtë. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit lidhur me protokollet e sigurisë, rënia e numri të rasteve të denoncuara, transparenca e kufizuar në lidhje me rezultatet e hetimeve nga prokuroria dhe të dhënat e paplota për proceset gjyqësore kufizojnë efektivitetin e perceptuar të mekanizmave mbrojtës. Aksionet nga organet e zbatimit të ligjit për rastet me profil të lartë që kishin të bënin me mediat gjatë vitit 2025 nxorën më shumë në pah rëndësinë e proporcionalitetit dhe qëndrueshmërisë në zbatimin e masave mbrojtëse.

Teksa Shqipëria po ecën përpara në procesin e anëtarësimit në BE, veçanërisht në kuadër të grup-kapitullit të Bazave, reforma në fushën e lirisë së medias hyn në një fazë ku vetëm respektimi i procedurave është i pamjaftueshëm. Besueshmëria e reformës do të varet gjithnjë e më shumë nga zbatimi i dukshëm, konsolidimi i institucioneve, transparenca e rezultateve dhe mbrojtja e vazhdueshme në praktikë e lirisë së shprehjes.

5.2. Rekomandime

Të përafrohet kuadri ligjor me standardet evropiane: Shqipëria duhet të harmonizojë në mënyrë sistematike kuadrin e saj ligjor dhe rregullator me kërkesat e Aktit Evropian për Lirinë e Medias dhe Aktit të Shërbimeve Digjitale, duke garantuar përafrim koherent të standardeve lidhur me pavarësinë e medias, pluralizmin, transparencën e pronësisë, financave dhe ndikimit, mbrojtjen e gazetarëve dhe profesionistëve të medias, llogaridhënien e platformave, masat mbrojtëse për moderimin e përmbajtjes dhe masat për zvogëlimin e rreziqeve. Ky harmonizim duhet të shoqërohet me rregulla të qarta për zbatimin e tyre, mekanizma të pavarur mbikëqyrjeje dhe kapacitete efektive zbatimi për të parandaluar përputhshmërinë formale pa ndikim substancial.

Të forcohet reforma e ligjit për shpifjen në përputhje me standardet evropiane: Të garantohet harmonizimi koherent dhe gjithëpërfshirës i dispozitave penale dhe civile për shpifjen me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Direktivën (BE) 2024/1069 kundër SLAPP dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës për Anti-SLAPP; Të shmangen qasjet e fragmentuara ose të fokusuara në profesionetë caktuara që mund të krijojnë pasiguri ligjore ose mbrojtje të pabarabartë në kuadër të debatit publik.

Të garantohet zbatimi efektiv i kornizave për sigurinë e gazetarëve: Të forcohet zbatimi operacional i protokolleve ekzistuese të sigurisë përmes ndjekjes sistematike, publikimit transparent të rezultateve hetimore dhe treguesve të matshëm të performancës në të gjitha institucionet e policisë dhe prokurorisë me qëllim rritjen e parandalimit dhe besueshmërisë institucionale.

Të institucionalizohet gjurmueshmëria në proceset legjislative dhe ato të reformës: Të hartohen mekanizma të qartë proceduralë për të dokumentuar se si përfshihen, modifikohen ose refuzohen në hartimin e ligjeve rekomandimet që dalin nga proceset e dialogut të strukturuar, duke garantuar transparencë, vazhdimësi dhe besim në rrugën e reformave.

Të forcohet mbrojtja strukturore për pluralizmin e medias: Të plotësohen mekanizmat e transparencës së pronësisë me masa të detyrueshme që trajtojnë rreziqet e përqendrimit të pronësisë dhe ndikimit të padrejtë, përfshirë këtu mbikëqyrjen koherente në të gjithë sektorët audiovizualë dhe digjitalë, si dhe forcimin e pavarësisë së institucioneve rregullatore.

Të rritet monitorimi mbi mediat gjatë periudhës zgjedhore dhe të përmirësohet reagimi ndaj dezinformimit: Të përmirësohet kapaciteti cilësor i monitorimit gjatë periudhave zgjedhore, të garantohet raportimi transparent i gjetjeve të monitorimit dhe të dokumentohen qartë zbatimi dhe rezultatet e nismave për ngritjen e kapaciteteve lidhur me dezinformimin, siç parashikohet në Udhërrëfyes.

Të forcohet zbatimi i të drejtave në punë në sektorin e medias: Të institucionalizohen metodologjitë e inspektimit të bazuara në risk me fokus të veçantë sektorin e medias dhe të përmirësohet transparenca e rezultateve të inspektimit në punë, duke trajtuar dobësitë e vazhdueshme që lidhen me kontratat e pasigurta dhe pasigurinë e vendit të punës.

Të trajtohen rreziqet e sigurisë me bazë gjinore: Të forcohet reagimi institucional ndaj kërcënimeve dhe ngacmimeve me bazë gjinore kundër grave gazetare, të sigurohen kanale raportimi të disponueshme për gratë gazetare dhe të integrohen masa me bazë gjinore brenda kornizave më të gjera të sigurisë për gazetarët.

Të përmirësohet transparenca dhe disponueshmëria e të dhënave: Të krijohen forma raportimi të strukturuar dhe të aksesueshëm për publikun lidhur me rastet që përfshijnë gazetarët në të gjithë institucionet e policisë, prokurorisë dhe ato gjyqësore, përfshirë këtu të dhëna për hetimet, ndjekjen penale, pushimet e çështjeve dhe vendimet gjyqësore, për të bërë të mundur monitorimin efektiv dhe për të ngushtuar hendekun aktual lidhur me transparencën.

RAPORTI VJETOR 2025:
Ndjekja e progresit të Shqipërisë
në lirinë e medias dhe sigurinë e
gazetarëve në përputhje me standardet
e BE-së

